



AVOKATI I POPULLIT

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçantë

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. *K2/I20-29* Prot.
Nr. Dok. 202001699/29

Tiranë *17/11/2020*

Lënda: *Rekomandime mbi veprimet/mosveprimet e kundërligjshme të strukturave të Policisë së Shtetit gjatë dhe pas prishjes së godinës së Teatrit Kombëtar.*

MINISTRISË SË BRENDSHME

Ministrit
Z. Sandër Lleshaj

Tiranë

DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË POLICISË SË SHTETIT

Drejtorit të Përgjithshëm
Drejtues Madhor Ardi Veliu

Tiranë

DREJTORISË VENDORE TË POLICISË TIRANË

Drejtorit
Drejtues i Parë Rebani Jaupi

PROKURORISË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË

Tiranë

Të nderuar zotërinj,

Institucioni i Avokatit të Popullit ka ndjekur me vëmendje të veçantë ngjarjet që lidhen me Teatrin Kombëtar dhe me shqetësim të thellë ato të ndodhura në orët e para të mëngjesit të datës 17.05.2020, në Teatrin Kombëtar dhe protestave në orët në vijim. Në këtë datë rreth orës 04:30, Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit të Bashkisë Tiranë, i mbështetur nga forca të Policisë së Shtetit dhe Policisë Bashkiake Tiranë, zbatoi vendimin e Këshillit Bashkiak Tiranë, për shembjen e godinës së Teatrit Kombëtar (TK).

Ideja dhe vendimmarrjet për shembjen e Teatrit Kombëtar, janë kundërshtuar nga shtetas të ndryshëm, përfshirë edhe figura të njohura të fushës së artit, kulturës, apo personalitete të tjera. Këta shtetas kanë shprehur mendimin e tyre kundër idesë së prishjes së TK goftë në mënyrë spontane apo të organizuar, si psh. lëvizja me emrin “*Aleanca për Mbrojtjen e Teatrit*”. Para sheshit të Teatrit Kombëtar, për muaj me radhë janë organizuar një numër jo i vogël takimesh me qëllim ndërgjegjësimin e opinionit publik lidhur me arsyet pse kjo godinë nuk duhet të shembej, si dhe janë hedhur ide se çfarë veprimesh mund të kryheshin për ta bërë atë funksional e rijetëzuar. Debati ka tërhequr vëmendjen e opinionit publik për një kohë të gjatë dhe është pasqyruar gjerësisht në median e shkruar dhe atë vizive. Në mbrotje të idesë për të ruajtur godinën e TK, kanë reaguuar edhe institucione dhe organizata të ndryshme, brenda dhe jashtë vendit, ku do të veçonim kërkesën e depozituar në Gjykatën Kushtetuese nga Presidenti i Republikës, me objekt: Shpalljen antikushtetues të ligjit për shembjen e Teatrit Kombëtar.

Pas vendimit të marrë nga Këshilli Bashkiak Tiranë për prishjen e godinës së Teatrit Kombëtar¹ pati një ngritje të toneve nga palët e përfshira në mbrojtjen e kësaj godine, të cilët e kanë konsideruar vendimin të kundërligjshëm dhe shtetas të ndryshëm u shprehën në atë kohë se do të bënin qëndresë dhe nuk do të lejonin prishjen e godinës.

Vlen për t’u theksuar se si Vendimi i Këshillit Bashkiak Tiranë, ashtu edhe kryerja e operacionit nga dy institucionet e lartpërmendura në zbatim të tij, janë realizuar në një periudhë krejtësisht të pazakontë. Në një kohë kur e gjithë veprimtaria ekonomike, administrative dhe shoqërore në vend ishte mbyllur apo kufizuar, si masë mbrojtëse ndaj përhapjes së Virusit COVID-19, kur institucionet shtetërore kishin miratuar akte që kufizonin liri dhe të drejta të individëve me qëllim ruajtjen e shëndetit dhe jetës, nga disa institucione shtetërore, u kryen veprime që përfshinë një numër të madh punonjësish në të njëjtin vend, pavarësisht se grumbullimet masive ishin rreptësisht të ndaluara.

Procesi i shembjes së godinës së Teatrit Kombëtar nuk kaloi në mënyrë të qetë. Në media u raportua se kishte patur përdorim të dhunës nga punonjës të policisë dhe si pasojë të lënduar. Disa persona që qëndronin brenda dhe pranë godinës së Teatrit Kombëtar në çastin e fillimit të operacionit për shembjen e godinës së Teatrit Kombëtar, janë shoqëruar në Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë dhe Komisarariatet e Policisë Tiranë. Me zbardhjen e ditës, disa orë pas fillimit të shembjes së godinës, dhjetëra qytetarë janë mbledhur duke protestuar rreth gardhit policor të vendosur për të siguruar veprimet e punonjësve të IMT-së. Edhe gjatë kësaj proteste janë raportuar raste dhune nga ana e Policisë së Shtetit dhe qytetarë të tjerë janë shoqëruar në Komisarariatet e Policisë Tiranë.

Institucioni i Avokatit të Popullit, në ushtrim të mandatit kushtetues si mbrojtës i të drejtave dhe lirive themelore të individit ndërmoi fillimisht me iniciativë shqyrtimin e këtij rasti për të verifikuar ligjshmërinë e veprimeve të punonjësve të Policisë së Shtetit gjatë dhe pas operacionit për shembjen e godinës së Teatrit Kombëtar si dhe ligjshmërinë e procedurës së ndjekur për marrjen e këtij vendimi. Më pas janë paraqitur edhe disa ankesa nga shtetas të cilët pretendonin se ishin dhunuar nga disa punonjës të policisë.

¹ Vendimi i Këshillit Bashkiak, Tiranë Nr.50, datë 14.05.2020 “Për miratimin e shembjes së godinës së Teatrit Kombëtar, pasuri në pronësi të Bashkisë Tiranë”.

Gjetjet që do të parashtrorjmë më poshtë kanë të bëjnë vetëm me veprimet ose mosveprimet e Policisë së Shtetit dhe jo të institucioneve të tjera shtetërore të përfshira në procesin e prishjes së godinës së ish Teatrit Kombëtar.

Veprimet e kryera nga Institucioni i Avokatit të Popullit

Paraditen e datës 17.05.2020, pas informacioneve në media për veprimet e punonjësve të Policisë së Shtetit, Avokati i Popullit organizoi punën në grupe me ekspertë të institucionit për të vizituar Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë dhe të gjitha Komisarariatet e Policisë Tiranë, për të marrë takim me personat e shoqëruar dhe dëgjuar dëshmitë tyre, për të këqyrur shënimet e lëna në regjistrin e personave të shoqëruar, për të administruar dokumentacionin që lidhet me ngjarjen si dhe për të parë në vend masat e marra në zbatim të protokolleve për parandalimin e përhapjes së virusit COVID-19.

Ditën e ngjarjes dhe në ditët në vijim janë marrë deklaratimet me shkrim të 11 shtetasve, të cilët janë shoqëruar në ambientet e Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë dhe/ose në komisarariatet në varësi të saj.

Në kuadër të një hetimi të plotë administrativ, u jemi drejtuar me shkresa disa institucioneve për të marrë informacion dhe dokumente që lidhen me ngjarjen dhe pretendimet e ngritura për veprimet e kundërligjshme të Policisë së Shtetit. Më konkretisht, u jemi drejtuar institucioneve si vijon: Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit; Komisariateve të Policisë Nr.1, 2, 3, 4 dhe 6; Ministrisë së Brendshme, Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesave; Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë; Institutit të Mjekësisë Ligjore; Spitalit Universitar të Traumës.

Po ashtu, janë administruar disa pamje video/audio të regjistruara nga mediat si dhe nga persona të shoqëruar për ngjarjen, të cilat janë gjendur në rrjetin social YouTube.

Ankesat e ngritura lidhur me veprimet e Policisë së Shtetit

Ankesat e paraqitura me shkrim nga personat e shoqëruar në organet e Policisë Tiranë dhe ato të shprehura në media po i rendisim si më poshtë: (sqarojmë se jo të gjithë ankuesit kanë patur ankesa të njëjta)

- Dhunë fizike dhe verbale të ushtruar nga disa punonjës të policisë gjatë operacionit për shembjen e godinës së TK, në makinën e policisë gjatë shoqërimit për në komisarariat dhe gjatë protestës së mbajtur pas shembjes së godinës;
- Mjetet e IMT kanë nisur të shembin godinën e TK ndërkohë që brenda saj ka patur persona, aktivistë për mbrojtjen e teatrit;
- Para se të niste shembja e godinës së TK, brenda saj janë futur forca të Policisë së Shtetit të armatosur, të cilët kanë kërcënuar aktivistë të "Aleancës për Mbrojtjen e Teatrit";
- Punonjësit e Policisë së Shtetit nuk kanë patur numër identifikimi në uniformën e tyre;
- Punonjësit e Policisë së Shtetit që kanë kryer veprime me personat e shoqëruar nuk i kanë vënë në dispozicion këtyre të fundit dokumentacionin që kanë nënshkruar;

- Ndaj qytetarëve është përdorur pa arsye sprajt djegës;

Vlerësimi i Institucionit të Avokatit të Popullit

- *Shembja e godinës së Teatrit Kombëtar në kohë pandemie*

Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit (IMT), me shkresën nr.15806 Prot., datë 15.05.2020, i ka kërkuar disa institucioneve mbështetje gjatë operacionit për shembjen e godinës së TK nga data 15.05.2020 deri në ekzekutimin e plotë, duke respektuar grafikun e punimeve. Në përgjigje të kësaj kërkesë, Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë në përmbushje të detyrimit për të bashkëpunuar me institucionet e administratës, ka miratuar planin e masave me shkresën Nr.3601/1 Prot., datë 15.05.2020. Duhet nënvizuar fakti që ky plan masash është hartuar në të njëjtën ditë me dërgimin e kërkesës për mbështetje, çka tregon që ky veprim është kryer në kushtet e urgjencës duke mos marrë masat e nevojshme në përputhje me ligjin për menaxhimin e situatës.

Kjo detyrë e Policisë së Shtetit për të bashkëpunuar me institucionet e administratës parashikohet si në ligjin organik të saj ashtu dhe akte nënligjore.

Kështu, Ligji Nr.108/2008 “Për Policinë e Shtetit”, përcakton se:

“1. Në përmbushjen e përgjegjësiave të saj, policia bashkëpunon me institucionet e administratës shtetërore, me personat fizikë e juridikë.

2. Strukturat vendore të policisë bashkëpunojnë me njësitë e qeverisjes vendore për parandalimin e krimit, në fushën e rendit dhe të sigurisë publike, duke respektuar pavarësinë e tyre.” (Neni 78)

Ndërsa në VKM Nr.750, datë 16.9.2015 “Për Miratimin e Rregullores së Policisë së Shtetit”, neni 82 “Bashkëpunimi me institucionet e administratës shtetërore dhe njësitë e qeverisjes vendore” ndër të tjera prashikohet se:

“1. Në veprimtarinë e saj Policia e Shtetit bashkëpunon me institucionet e tjera të administratës shtetërore, me njësitë e qeverisjes vendore dhe me shoqërinë civile.

2. Bashkëpunimi me institucionet e tjera të administratës shtetërore realizohet mbi bazën e një dokumenti/aktmarrëveshje bashkëpunimi.

3. Bashkëpunimi me njësitë e qeverisjes vendore realizohet nga strukturat vendore të Policisë, për parandalimin e krimit, në fushën e rendit dhe të sigurisë publike.”

Në zbatim të akteve të sipërpërmendura, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit ka miratuar me Urdhrin Nr.255, datë 15.03.2017 Procedurën Standarde të Punës “Për bashkëpunimin dhe mbështetjen institucionale që Policia e Shtetit i jep institucioneve të tjera shtetërore”. Në këtë procedurë², ndër të tjera, përcaktohet se strukturat e Policisë së

² Konkretisht, në Procedurën Standarde të Punës “Për bashkëpunimin dhe mbështetjen institucionale që Policia e Shtetit i jep institucioneve të tjera shtetërore”, miratuar me Urdhrin Nr.255, datë 15.03.2017 të DPPSH parashikohet:

I. Politika

Strukturat e Policisë së Shtetit në kuadër të bashkëpunimit ndërinstitucional dhe në bazë të aktmarrëveshjeve të përbashkëta me organet/institucionet e tjera shtetërore, ndihmojnë dhe mbështetin këto institucione për

Shtetit në kuadër të bashkëpunimit ndërinstitucional dhe në bazë të aktmarrëveshjeve të përbashkëta me organet/institucionet e tjera shtetërore, ndihmojnë dhe mbështetin këto institucione për zbatimin e akteve ligjore, në rastet kur ka arsye të mjaftueshme për të besuar se ndaj përfaqësuesve të tyre mund të ushtrohet dhunë.

Në Planin e Masave të DVP Tiranë thuhet se, mbështetja kryhet për të garantuar rendin, sigurinë dhe parandaluar veprime të dhunshme nga përfaqësues të Aleancës për Mbrojtjen e Teatrit dhe mbështetës të tyre, të cilët në disa raste kur është ndërhyrë për të bërë inventarin e materialeve në objekt kanë bërë rezistencë me veprime të dhunshme si dhe kanë bërë thirrje të vazhdueshme për rezistencë nëse godina e TK do të shembej.

Referuar rregullave të bashkëpunimit me institucionet e tjera, Policia e Shtetit nuk duhet të mjaftohet vetëm me vlerësimin nëse do të ketë ose jo rezistencë të dhunshme nga qytetarë ndaj punonjësve të administratës. Policia e Shtetit nuk mund të veprojë si një “*ushtar që bindet verbërisht*” kur merr një kërkesë për mbështetje nga një institucion tjetër. Policia e Shtetit duhet të verifikojë nëse kërkesa e paraqitur është e plotë dhe ligjore dhe para kryerjes së veprimeve për mbështetje, të kontaktojë me drejtues të institucioneve që kanë paraqitur kërkesë, të shkëmbejë me ta informacione më të hollësishme dhe të vlerësojë situatën që mund të krijohet. Detyra për të qenë më i vëmendshëm ndaj kërkesave të institucioneve që i jepet Policisë së Shtetit nga rregullat e përcaktuara në urdhrin e DPPSH, por vlerësojmë edhe nga arsyeja e mbarëvajtjes së punëve merr më shumë peshë gjatë gjendjes së emergjencës shëndetësore për shkak të virusit COVID-19. Është i vërtetë fakti që institucionet shtetërore duhet të vazhdojnë veprimtarinë e tyre pavarësisht gjendjes së diktuar nga përhapja e virusit, por është po aq e vërtetë që institucionet duhet të vlerësojnë me maturi domosdoshmërinë e veprimeve që do të kryejnë dhe pasojat që vijnë/mund të vijnë nga kryerja e tyre. Ata gjithashtu duhet të vlerësojnë se cilat veprime duhet të kryhen e cilat jo, duke vënë në balancë nevojën për garantimin e jetës si një detyrë parësore e më pas zbatimin e kërkesave për ndihmë.

A përbënte emergjencë dhe domosdoshmëri shembja e godinës së TK në kohë pandemie?

Reagimi i qytetarëve që kishin dalë në mbrojtje të idesë se godina e TK nuk duhej shembur ishte i pritshëm. Gjithashtu, referuar Planit të Masave, vetëm nga Policia e Shtetit do të

zbatimin e akteve ligjore, në rastet kur ka arsye të mjaftueshme për të besuar se ndaj përfaqësuesve të tyre mund të ushtrohet dhunë.

II. Procedura

A. Procedurat që ndiqen me marrjen e kërkesës nga organet dhe institucionet shtetërore për ndihmë dhe mbështetje.

1. Drejtuesit e Drejtorisë Vendore të Policisë/Komisariatit Vendor të Policisë, duhet të shqyrtojnë përmbajtjen e kërkesës së organeve/institucioneve shtetërore për ndihmë/mbështetje dhe të verifikojnë nëse kërkesa e paraqitur është e plotë dhe ligjore.

2. Nëse rezulton se kërkesa e organeve/institucioneve shtetërore nuk është e plotë apo ligjore, drejtuesit e Drejtorisë Vendore të Policisë/Komisariatit Vendor të Policisë i kërkojnë autoritetit kërkues që ta përsërisin kërkesën, duke e plotësuar atë. Nëse kërkesa nuk ndryshohet dhe plotësohet ajo do të quhet e pavlefshme.

.....

5. Është e nevojshme që drejtues të shërbimeve policore në Drejtorinë Vendore të Policisë/Komisariatit Vendor të Policisë, para kryerjes së veprimeve për mbështetje, të kontaktojnë me drejtues të institucioneve që kanë kërkuar ndihmën e mbështetjen. Në këtë takim të shkëmbehen informacione më të hollësishme, të vlerësohet situata e krijuar e në varësi të saj të përcaktohen bashkërisht detyrat dhe masat më efikase për realizimin e mbështetjes pa probleme.

angazhoheshin në operacion **449** punonjës të strukturave të ndryshme pa përllogaritur numrin e punonjësve të Forcës Operacionale Lëvizëse, numri i të cilëve nuk na është dhënë. Këtij numri duhet t'i shtojmë edhe punonjësit e Policisë Bashkiake, punonjësit e IMT-së dhe ato të Bashkisë Tiranë. Pra një numër i konsiderueshëm personash, protestues dhe punonjës shtetërorë, do të gjendeshin pranë njëri-tjetrit në një kohë kur ishin në fuqi masat që parashikonin ndalimin e grumbullimeve masive dhe detyrimin për distancim fizik dhe zbatimin e rregullave të tjera në kuadër të masave të marra për parandalimin e përhapjes së virusit COVID-19. Në orët e para, pas fillimit të operacionit, janë shoqëruar në DVP Tiranë dhe komisariatet e Tiranës 33 persona, përkatësisht: 11 (njëmbëdhjetë) persona në Komisaratin e Policisë nr.1; 4 (katër) persona në Komisaratin e Policisë Nr.2; 5 (pesë) persona në Komisaratin e Policisë Nr.3; 10 (dhjetë) persona në Komisaratin e Policisë Nr.4; 2 (dy) persona në Komisaratin e Policisë Nr.6; 1 (një) person në Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë.

Nga ana jonë iu kërkua Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë të na informojë nëse ka pasur masa të planifikuara për këtë veprimtari operacionale, në kuadër të detyrimeve të parashikuara në Aktin normativ Nr.3, datë 15.03.2020 *“Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19”*. Në përgjigjet që kemi marrë,³ thuhet se:

“Në zbatim të Aktit Normativ Nr.3, datë 15.03.2020 “...” DVP Tiranë, nga data 13.03.2020 edhe në vazhdim, si dhe gjatë mbështetjes së IMT-së, në datën 17.05.2020, janë marrë masat duke pajisur punonjësit e policisë me maska respiratore, doreza plastike, si dhe është kryer dezinfektimi i të gjitha ambienteve të brendshme dhe të jashtme, mjediseve dhe mjeteve zyrtare, sallat operative, dhomat e shoqërimit/sigurisë dhe mjetet lëvizëse të shërbimit.”

“Drejtorja Vendore e Policisë Tiranë dhe strukturat vartëse të saj, që prej fillimit të pandemisë kanë marrë masat për parandalimin e përhapjes së COVID-19, duke u bazuar në Aktet normative të nxjerra nga Qeveria, udhëzimet e nxjerra nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale si dhe në urdhrat dhe udhëzimet e nxjerra nga Drejtorja e Përgjithshme e Policisë së Shtetit duke pajisur punonjësit e policisë me maska respiratore, doreza si dhe bëri dezinfektimin e të gjitha ambienteve të brendshme dhe të jashtme, mjediseve dhe mjeteve zyrtare, dhomat e shoqërimit/sigurisë dhe mjetet lëvizëse të shërbimit.”

Në Planin e Masave të operacionit në fjalë lihet detyrë që të pajisen efektivët me maska dhe doreza kundër COVID-19, etj.

Në lidhje me rregullat e parashikuara për administratën në mënyrë që të parandalohet përhapja e virusit COVID-19 dhe nëse janë zbatuar këto rregulla nga Policia e Shtetit gjatë operacionit në terren dhe në mjediset e komisariateve i referohemi Udhëzuesit *“Për administratën/Punët në zyrë dhe terren (COVID-19)”* që Instituti i Shëndetit Publik me

³ Shkresa Nr.3274/1 Prot., datë 13.06.2020 e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe shkresat me Nr.3601/13 Prot., datë 10.06.2020 dhe Nr.4952/1 prot., datë 16.07.2020, të Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë.

shkresën Nr.496/11 Prot., datë 29.04.2020, u ka dërguar institucioneve të administratës. Nga ky udhëzues po veçojmë disa rregulla të renditura si më poshtë:

- Të sigurohen në mënyrë të vazhdueshme elementët e higjenës ku përfshihen: sapun i duarve, dezinfektantët me bazë alkooli që kanë të paktën 60% alkool, letër të pastrimit të duarve ose peshqir me një përdorim për pastrimin e sipërfaqeve dhe sigurimi i koshave të mbyllur për eliminimin e mbetjeve;
- Të krijohen kushte të cilat do të lejojnë një kombinim të punës nga shtëpia, orë fleksible të orarit të zakonshëm të punës, të cilat mundësojnë të rritet distanca fizike nga një punonjës në tjetrin ose/ dhe krijojnë mundësinë e këtyre punonjësve të jenë në distancë 2 metra nga njëri-tjetri;
- Punonjësit duhet të respektojnë masat e distancimit social dhe fizik të cilat do të kryhen sipas një plani të vetë institucionit duke respektuar distancën 2 metra;
- Punonjësit duhet të vendosin maska mbrojtëse ose mbrojtëse të fytyrës prej tekstili, të cilat duhet të lahen në 60 gradë dhe hekurosen, si dhe shami letre për higjenën e hundëve;
- Të minimizohet kontakti midis qytetarëve dhe punonjësve duke i zëvendësuar takimet me komunikime online.
- Punonjësit e administratës për udhëtimet në terren duhet të respektojnë rregullat e distancimit fizik gjatë udhëtimit dhe në terren.

Nga këqyrja e pamjeve filmike që mediat kanë fiksuar gjatë operacionit për shembjen e TK rezulton se një pjesë e punonjësve të Policisë së Shtetit nuk mbanin maska. Dinamika e ngjarjes ka sjellë mos respektimin e distancimit nga punonjësit e policisë me njëri-tjetrin, punonjësit e policisë me qytetarët protestues, si dhe protestuesit me njëri-tjetrin. Jo vetëm dinamika e ngjarjes në rastin konkret, por çdo dinamikë e mundshme e saj, do të çonte në mënyrë të padiskutueshme në shkeljen e masave anti-COVID-19 në fuqi, ndaj për këtë arsye në vlerësimin tonë, do duhet të ishin vënë në balancë, shkelja me vetëdije e masave anti-Covid-19, apo shtyrja e kryerjes së shembjes së teatrit dhe mbështja e tij me anë të operacionit policor në një kohë të dytë. Kjo edhe për vetë faktin se edhe sot, disa muaj pas shembjes së godinës së Teatrit Kombëtar, asnjë nga institucionet shtetërore të përfshira në procesin e shembjes së kësaj godine, nuk ka dhënë ndonjë arsye juridike, përse ky operacion u krye në kushtet kur vendi ynë ndodhej në kushte të pazakonta dhe se përse ishte domosdoshmëri shembja e TK në atë moment kohor.⁴

Grupet u punës të Institucionit të Avokatit të Popullit që kanë shkuar në komisariate paraditen e ngjarjes (datë 17.05.2020) po ashtu, kanë konstatuar se respektimi i distancës 2 metra ishte i pamundur për numrin e personave që qëndronin në dhomat shoqërim. Atyre nuk ju ishin dhënë maska dhe doreza. Në hyrje të dhomave të shoqërimit apo brenda tyre nuk u gjetën dezinfektantë. Shpërndarja e personave të shoqëruar nuk është bërë duke mbajtur parasysh rregullin e distancimit. Nga këqyrja e regjistrit të personave të shoqëruar në Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë ka rezultuar se gjatë paradites së datës 17.05.2020 dhoma e të shoqëruarve për meshkuj madhorë ka qenë bosh. Disa nga personat e shoqëruar mund të ishin mbajtur në mjediset e kësaj Drejtorie. Strukturat e Policisë së Shtetit nuk duhet të ishin treguar shpërfillëse ndaj situatës që pritej të krijohej nga operacioni për shembjen e TK. Udhëzimet e Institutit të Shëndetit Publik dhe kapacitetet e mjedisëve të komisariateve duhet të ishin marrë parasysh në pranimin e kërkesës për

⁴ Në lidhje me këto aspekte Institucioni do të dalë me një rekomandim të veçantë.

mbështetje të paraqitur nga IMT Bashkia Tiranë. Kjo edhe për faktin se, Akti normativ Nr.3, datë 15.03.2020 “Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19” ngarkon me kompetencë Policinë e Shtetit për dhënien e masave administrative me gjobë ndaj subjekteve, të cilët shkelin rregullat, vendimet, urdhrat dhe udhëzimet e nxjerra nga organet kompetente, gjatë gjithë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19. Ndaj disa personave të shoqëruar, të cilët kanë qenë të pranishëm brenda dhe jashtë TK, dhe në protestën që ka pasuar shembjen e godinës së TK janë dhënë masa administrative me gjobë për shkelje të Aktit normativ Nr.3, datë 15.03.2020. Duhet të jemi të vetëdijshëm se rregullat që ky akt referon nuk janë respektuar edhe nga vetë Policia e Shtetit.

Në kuadër të parimit të ligjshmërisë, padyshim strukturat e policisë do të duhej ta zbatonin ligjin në mënyrë të vërtetë si për vete, si për shtetasit ashtu edhe për autoritet e tjera shtetërore. Është e qartë se masat e marra nuk do të mund të arrinin qëllimin e duhur dhe se ky qëllim ishte i mundur vetëm në letër.

Policia e Shtetit në momentin që konstatonte se masat anticovid në fuqi të parashikuara nga akti normativ i sipërpërmendur nuk mund të zbatoheshin (me kapacitetet që dihehin se ishin të pamjaftueshme) duhet të kishte ngritur këtë shqetësim dhe propozuar zgjidhjet përkatëse. Po ashtu, në kushtet kur dihet se nuk kishte kapacitete akomoduese për personat që mund të shoqëroheshin, nuk rezultoi të jenë bërë konsultime, apo të jenë kërkuar udhëzime për mënyrën se si do të veprohej. Pra, u zgjodh një plan masash i tillë që do të sillte me shumë mundësi shkeljen nga ana e punonjësve të Policisë së Shtetit të masave anti COVID-19.

Theksojmë se, për shkak të mos marrjes së këtyre masave, punonjësit e policisë janë bërë një burim i mundshëm i përhapjes së virusit COVID-19 si brenda radhëve të tyre, ashtu edhe ndaj qytetarëve protestues dhe veçanërisht ndaj personave të shoqëruar.

Përgjegjësia parësore për zbatimin e masave që parandalojnë përhapjen e virusit bie mbi institucionet shtetërore. Mirëqeverisja nuk duhet të bazohet vetëm në forcën shtrënguese. Ndërgjegjësimi në masë i qytetarëve për të zbatuar rregullat e vendosura fitohet kur ato zbatohen nga vetë institucionet. Këta të fundit duhet të tregojnë vullnet për kapërcimin e gjendjes së pandemisë me sa më pak pasoja duke marrë vendime të matura, duke sheshuar konfliktet dhe jo duke i ushqyer ato. Në këtë rast ky vullnet ka munguar.

- *Orari i nisjes së operacionit për shembjen e godinës së TK*

Shumëkush ngriti pyetjen se përse operacioni duhet të niste menatë, rreth orës 04:30 të datës 17.05.2020 dhe jo gjatë paradites.

Nga ana jonë iu kërkua Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë të na informonte se pse ky operacion ishte kryer rreth orës 04:30. Sqarojmë se në kërkesën për mbështetje që IMT-ja i ka dërguar Policisë së Shtetit nuk përcaktohet orari për prishjen e godinës së TK.

Në përgjigjet që kemi marrë thuhet se:

“Koha e fillimit dhe përfundimit të shërbimit gjatë mbështetjes nuk është përcaktuar nga policia, por është diktuar nga grafiku i punimeve dhe koha e ndërhyrjes që bëri IMT-ja dhe përfaqësuesit e institucioneve të tjera.”

Bashkëlidhur dokumentacionit që na është vënë në dispozicion nga Policia e Shtetit (kërkesa mbështetëse e IMT-së dhe Plani i Masave të DVP Tiranë) nuk na është dërguar grafiku i punimeve.

Orari i veprimeve të IMT-së për të shembur objekte ka qenë edhe më parë objekt shqyrtimi nga Institucioni i Avokatit të Popullit. Qytetarë të banesave private që do të shembeshin janë ankuar se veprimet e IMT-së janë kryer në orët e para të mëngjesit, pa njoftim paraprak, kur ata kanë qenë në gjumë, duke rrezikuar jetën dhe shëndetin e tyre. Përmendim rastin e shembjes së disa banesave të zona e njohur me emrin “Bregu i Lumit” në datën 9 Prill 2019. Nga ana jonë pas hetimit administrativ u provua se, IMT-ja nuk kishte respektuar orarin e përcaktuar nga vetë ajo, (ora 10:00) dhe orarin e ekzekutimit të vendimit të parashikuar në nenin 171 të Kodit të Procedurës Administrative, sipas të cilit:

“Ekzekutimi i detyrueshëm në ditët e pushimit dhe festave zyrtare, si dhe ekzekutimi ndërmjet orës 19:00 – 07:00 mund të kryhet vetëm në rast urgjence nëse, si pasojë e mosekzekutimit, cenohet interesi publik, bazuar në një urdhër me shkrim të arsyetuar të organit kompetent për ekzekutimin”.

Pra, si rregull vendimet e marra nga administrata shtetërore ekzekutohen ndërmjet orës 07:00 - 19:00. Vlerësojmë se ky orar nuk është përcaktuar në mënyrë rastësore nga ligjvënësi. 12 orët e paradites përkrijnë me orarin biologjik të trupit të njeriut, kur ai është më i kthjellët edhe energjik për të kryer veprimtarinë e tij. Gjithashtu në këtë orar mund të ushtrohet më mirë parimi i transparencës së veprimtarisë së administratës (neni 5 i K.Pr. Administrative).

Një nga personat e shoqëruar në komisariat në orët e para të mëngjesit të datës 17.05.2020, gjatë kohës që ndodhej në makinën e policisë ka regjistruar në fshehtësi fjalët e punonjësve që e kanë prangosur dhe shoqëruar. Nga biseda e regjistruar kuptohet lodhja nervore e punonjësve, të cilët fajësojnë personat e ndodhur tek godina e TK se i kanë lënë pa gjumë dhe përdorin ndaj tyre fjalë fyese. Citojmë: *“Na lanë pa gjumë këta lidhe qenin”*, etj.

Qoftë edhe formalisht nuk na është vënë në dispozicion një urdhër me shkrim i arsyetuar për kryerjen e operacionit në orët e natës sikurse parashikohet në nenin 171 të Kodit të Procedurave Administrative. Siç shpjegoam më lart Policia e Shtetit duhet të verifikojë nëse kërkesa e paraqitur për mbështetje është e plotë dhe ligjore. Nëse jo, i kërkon institucionit të interesuar ta plotësojë atë.

Në vijim të analizës sonë, sjellim në vëmendjen Tuaj, parimin e ligjshmërisë në veprimtarinë e organeve publike të parashikuar në nenin 4, të Kodit të Procedurave Administrative, ku thuhet se:

“1. Organet publike ushtrojnë veprimtarinë e tyre në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara dhe legjislacionin e zbatueshëm në Republikën e Shqipërisë, brenda kufijve të kompetencave të tyre dhe në përputhje me qëllimin për të cilin janë dhënë këto kompetenca.”

- *Pjesëmarrja e Forcës Lëvizëse Operacionale (FLO) gjatë ndërhyrjes për shembjen e godinës së TK*

Një nga personat e shoqëruar në ambientet e policisë në orët e para të mënjesit ka deklaruar me shkrim se, *“disa punonjës të policisë kanë qenë të pajisur me armë zjarri, dhe kur është kufizuar nga duart, një prej tyre ia ka drejtuar armën në kokë”*. Edhe në media u dhanë dëshmi nga të pranishmit se punonjës të policisë të armatosur janë futur brenda godinës së TK. Në pamjet e regjistruara nga gazetarët dallohen punonjës të veshur me tutë të zeza, me maskë operacionale në kokë, të cilët mësyjnë në një nga dyert e TK dhe bëhen gardh para saj. Nuk kuptohet nëse këta punonjës kanë ose jo në brez armë zjarri. Në një moment të dytë të operacionit, kamerat kanë regjistruar punonjës të policisë, me uniformën e forcës RENE⁵, të cilët mbajnë në duar armë zjarri dhe po drejtohen nga pedonalja ndërmjet Ministrisë së Brendshme dhe Galerisë së Arteve në drejtim të Bulevardit *“Dëshmorët e Kombit”*. Një nga aktivistët për mbrojtjen e TK ka regjistruar në fshehtësi çastin kur punonjës të policisë janë futur brenda godinës për t’i larguar. Në pamje duken këmbët e punonjësve me veshje të zeza dhe tyta e një arme zjarri.

Për të verifikuar pretendimin e ankuesit se ishte kërcënuar me armë zjarri nga një punonjës i policisë, por edhe për të kuptuar arsyen e pranisë së strukturave speciale, të cilat sipas ligjit janë të përfshira në operacione të sigurisë së veçantë apo të neutralizimit të personave me rrezikshmëri të lartë, i kërkua Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë të na informonte për sa më poshtë:

- o Nëse kishin marrë pjesë tek TK forca të strukturave speciale operacionale;
- o Cili është informacioni që ka patur Policia e Shtetit mbi bazën e të cilit është kërkuar mbështetja e Forcës Lëvizëse Operacionale (FLO);
- o Cilat janë strukturat e FLO që janë dërguar tek TK dhe ku janë përdorur.

DVP Tiranë na ka vënë në dispozicion shkresën Nr.3601/2 Prot., datë 15.05.2020 ku i kërkohet Departamentit të Sigurisë Publike, mbështetja e shërbimeve të FLO-së nga data 15.05.2020 deri në shembjen e godinës së *“Teatrit Kombëtar”* me arsyetimin si vijon:

“Nisur nga situatat e mëparshme, ku punonjës të Teatrit kanë tentuar të kryejnë inventarin, kanë hasur në kundërshtinë e disa shtetasve, përfaqësues të Aleancës për Mbrojtjen e Teatrit. Këta të fundit që prej afro dy vjetësh protestojnë për mos prishjen e tij dhe herë pas here, të mbështetur nga qytetarë të tjerë, por edhe parti opozitare.

Përfaqësues të Aleancës për Mbrojtjen e Teatrit të mbështetur nga partitë opozitare kanë reaguar dhe bërë rezistencë, duke kryer dhe veprime të dhunshme ndaj punonjësve të teatrit por edhe të policisë duke i goditur dhe me sende të forta, gjë për të cilën janë kryer edhe veprimet përkatëse procedurale.

*Me qëllim parandalimin e ngjarjeve të rënda, garantimin e rendit publik, rritjen e sigurisë gjatë ekzekutimit nga IMT Bashkia Tiranë, për prishjen e godinave të *“Teatrit Kombëtar”*, më datë 15.05.2020 e në vazhdim, Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë ka marrë masa dhe hartuar një plan masash për realizimin e mbështetjes së Institucionit të IMT Bashkia Tiranë, të cilët janë të detyruar të përmbushin detyrat e tyre ligjore”*.

Në përgjigje⁶ të pyetjeve tona DVP Tiranë ka shpjeguar se:

⁵ Reparti i Neutralizimit të Elementit të Armatosur (RENEA).

⁶ Shkresa e Drejtorisë Vendore të Policisë Tirane me Nr.4952/1 Prot., datë 16.07.2020.

“DVP Tiranë nisur nga informacionet ka kërkuar mbështetjen me Forca Lëvizëse Operacionale dhe për faktin se Aleanca për Mbrojtjen e Teatrit, e cila së bashku me disa qytetarë dhe e mbështetur nga partitë opozitare, ka protestuar kundër shembjes së teatrit prej rreth 2 vitesh, është shprehur e vendosur se “do të mbrojë deri në fund teatrin, duke u përballur qoftë edhe fizikisht”.

Në disa raste kur është ndërhyrë nga punonjësit dhe përfaqësuesit e Institucionit të Teatrit Kombëtar për të bërë inventarin e materialeve në objekt është hasur në reagimin e tyre, duke bërë rezistencë dhe kryer veprime të dhunshme, thirrje të vazhdueshme për rezistencë dhe radikalizim të veprimeve të tyre nëse objekti i Teatrit do të prishet “mos luani me teatrin, sepse ne e kemi ndarë mendjen për rezistencë të fuqishme etj.”

Ndërsa Drejtorja e Përgjithshme e Policisë së Shtetit⁷ ka dhënë shpjegimin si më poshtë:

“Në vijim të kërkesës së DVP Tiranë (nr. 3601/2, datë 15.05.2020) drejtuar DPP Shtetit “Për mbështetje me Forca Lëvizëse Operacionale”, nga ana e Drejtorisë së Forcave Lëvizëse Operacionale është përgatitur Plani i Vendosijes së shërbimeve me nr. 545/k, datë 15.05.2020 “Për menaxhimin e situatës pranë Teatrit Kombëtar në datën 15.05.2020 e në vazhdim, deri në përmbushjen e detyrës”, ku është parashikuar mbështetja e strukturave vendore të policisë me forca dhe mjete nga kjo strukturë.

Veprimet për mbështetjen e shërbimeve policore të DVP Tiranë nga FLO janë kryer sipas Procedurave Standarte të Punës të këtyre strukturave dhe në asnjë rast nuk është ushtruar forcë e pa nevojshme.

Bazuar në pikën 3 të nenit 135 të Ligjit Nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, punonjësve të strukturave speciale operacionale u garantohet fshehtësia e identitetit për veprimtarinë operacionale.

Po kështu, referuar Kreut IV, pika 2, gërma, “b” të Ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, e kemi të pa mundur t’i përgjigjemi kërkesës tuaj për vënien në dispozicion të dokumentave të klasifikuara “sekret”.

Për rastin e prishjes së Teatrit Kombëtar, nga ana e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë është filluar një procedim penal, ku në funksion të tij sipas kërkesës së prokurorisë, Drejtorja e FLO ka dërguar të gjithë dokumentacionin e nevojshëm të hartuar për këtë qëllim.

Nisur nga fakti që Aleanca për Mbrojtjen e Teatrit së bashku me disa qytetarë të tjerë kanë kundërshtuar dhe protestuar në mënyrë të vazhdueshme prishjen e këtij objekti si dhe nga deklaratat e tyre se: “do të mbrojë deri në fund teatrin, duke u përballur qoftë edhe fizikisht”, “mos luani me teatrin, sepse ne e kemi ndarë mendjen për rezistencë të fuqishme, etj.”, nga ana e DVP Tiranë, është kërkuar mbështetje me shërbime të FLO.

Para se të ndërhynte për shembjen e godinës së Teatrit Kombëtar, punonjësit e policisë të strukturave vendore me mbështetje edhe të shërbimeve të FLO, fillimisht kanë marrë masa për largimin e personave të cilët kanë qenë brenda, duke komunikuar, nxjerrë dhe larguar nga objekti”.

Në Planin e Masave për ndërhyrjen te TK parashikohet bashkëpunimi i punonjësve të Policisë së DVP Tiranë me FLO-në. Më konkretisht, FLO do të vepronte për të ndërhyrë në rast se do të kishte rezistencë, dhunë, kundërshtime të punonjësve të policisë dhe pengim të punonjësve dhe përfaqësuesve të institucioneve ligjzbatuese. Me vënien nën

⁷ Shkresa me Nr.3274/3 Prot., datë 24.07.2020.

kontroll të situatës, punonjësit e policisë së DVP Tiranë do të bashkëpunonin sipas planit të tyre, duke nxjerrë shtetas nga objekti i teatrit, duke i shoqëruar ata dhe duke i mbajtur larg perimetrit të krijuar nga policia.

Sipas shpjegimeve të dhëna nga DVP Tiranë⁸ dhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë Tiranë rezulton se:⁹

“Para se të ndërhyhej për shembjen e godinës së teatrit punonjësit e policisë të strukturave vendore me mbështetje dhe të shërbimeve të FLO, fillimisht kanë marrë masa për largimin e personave të cilët kanë qenë brenda, duke komunikuar, nxjerrë dhe larguar nga objekti. Një pjesë e personave që kanë qenë brenda ambienteve të teatrit kanë bërë rezistencë dhe nuk kanë pranuar të largohen nga objekti duke kundërshtuar punonjësit e policisë dhe përfaqësuesit e IMT-së, për të cilën janë shoqëruar në ambientet e policisë.”

“Gjatë ekzekutimit të vendimit për prishjen e godinës së Teatrit Kombëtar dhe më pas, qytetarë të ndryshëm janë grumbulluar në kundërshtim me kërkesat e Aktit normativ, i cili ndalon në situatë pandemie grumbullime dhe protesta, ata kanë kundërshtuar veprimet e punonjësve të IMT, kanë protestuar duke shtyrë me forcë kordonin e policisë, goditur me sende të forta, gurë dhe kapsolla punonjësit e policisë si dhe kanë bllokuar rrugët pranë vendit të ekzekutimit të vendimit.”

Sa i përket analizimit të ndërhyrjes së strukturave speciale operacionale të policisë, i referohemi Ligjit Nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”¹⁰ dhe VKM Nr. 750, datë 16.09.2015 “Për miratimin e Rregullores së Policisë së Shtetit”¹¹ ku parashikohet se,

⁸ Shkresa me Nr.4952/1 Prot., datë 16.07.2020.

⁹ Shkresat me Nr.3274/1 Prot., datë 18.06.2020 dhe me Nr.3274/3 Prot., datë 24.07.2020.

¹⁰ Në nenin 135 të Ligjit Nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit” parashikohet se:

1. Për kryerjen e operacioneve të sigurisë së veçantë dhe zgjidhjen e situatave, të cilat nuk mund të përballohen nga shërbimet e tjera të policisë, përdoren struktura speciale operacionale të policisë.

2. Përgjegjësitë e këtyre strukturave janë:

a) çlirimi i pengjeve;

b) kapja e personave të armatosur me rrezikshmëri të lartë dhe transportimi i tyre në mjediset e policisë;

c) mbështetja e strukturave, të cilat sigurojnë personalitetet e larta shtetërore, të vendit ose të huaja, në rastet kur ka të dhëna për akte terroriste ndaj tyre;

ç) rivendosja e rendit dhe e sigurisë publike, kur kjo është e pamundur vetëm me strukturat e tjera policore;

d) marrja në ruajtje e personave, të cilëve u kërcënohet jeta për shkak të detyrës.

3. Punonjësve të strukturave speciale operacionale u garantohet fshehtësia e identitetit për veprimtarinë operacionale.

4. Kur nga punonjësit e policisë së strukturave speciale operacionale, gjatë u shtrimit të detyrës së tyre, para ose pas operacionit kryhen vepra penale, ndaj tyre ndiqen procedurat ligjore si për gjithë shtetasit e tjerë.

Drejtoria e Policisë së Shtetit duhet të vërë në dispozicion të organeve të drejtësisë personat dhe dokumentacion e nevojshëm, me qëllim kryerjen e hetimeve.

Prokuroria dhe gjykata të zbatojë metodat dhe format ligjore të procedimit, të cilat garantojnë sekretin e klasifikuar policor, sipas nenit 14, të ligjit nr. 8839, datë 22.11.2001, "Për grumbullimin, administrimin dhe ruajtjen e informacionit të klasifikuar policor".

5. Funksionimi i strukturave speciale operacionale, si dhe procedurat, rregullat dhe kriteret e përdorimit të tyre përcaktohen nga Drejtori i Policisë së Shtetit.

¹¹ Në nenin 26 “Strukturat e veçanta”, të VKM Nr. 750, datë 16.09.2015 përcaktohet si më poshtë:

1. Strukturat e veçanta ushtrojnë veprimtarinë e tyre në të gjithë territorin e vendit ose në pjesë të veçanta të tij dhe janë në varësi të Drejtorit të Policisë së Shtetit.

2. Strukturat e veçanta janë shërbime policore të specializuara apo të profilizuara për të kryer:

a) detyra specifike;

strukturat speciale operacionale të policisë përdoren për kryerjen e operacioneve të sigurisë së veçantë dhe zgjidhjen e situatave, të cilat nuk mund të përballohen nga shërbimet e tjera të policisë si dhe përgjegjësitë përkatëse.

Po t'i referohemi ligjit dhe informacionit të Policisë së Shtetit, kjo e fundit ka vlerësuar se kishte pritshmëri që situata të mos kontrollohej vetëm nga strukturat e tjera policore dhe punonjësve mund t'u kërcënohej jeta. Pritshmëria është krijuar nga episode të mëparshme rezistence të qytetarëve ndaj punonjësve të policisë dhe deklaratat e tyre kërcënuese nëse do të ndërhyhej për shembjen e TK. Për këtë arsye është kërkuar mbështetja e FLO.

Vlerësojmë se ndërhyrja e FLO në rastet e parashkuara në shkronjën “ç” dhe “d” të nenit 135 të Ligjit Nr. 108/2014 “*Për Policinë e Shtetit*”, për rivendosjen e rendit publik dhe ruajtjen e personave që u kërcënohet jeta për shkak të detyrës, duhet të bëhet vetëm në raste kur me të vërtetë ka informacion për një rrezik të shtuar, të diktuar nga pjesëmarrja e elementëve me rrezikshmëri të lartë dhe përdorimi i armëve. Në të kundërt mund të kërkohej mbështetja e FLO në çdo grumbullim, protestë apo qëndresë të qytetarëve, sepse pothuajse çdo herë bëhen deklaratat kërcënuese, ngrihen tonet dhe ka kundërshtim pasiv ose aktiv të punonjësve të policisë. Për t'u evidentuar është fakti që Policia e Shtetit nuk ka referuar për gjetjen e armëve të TK dhe në urgjencën e Spitalit Universitar të Traumës janë paraqitur 6 punonjës policie me lëndime të lehta, të cilat janë shkaktuar gjatë protestës që ka pasuar shembjen e godinës së TK. Protesta ka qenë e përmasave shumë më të vogla se ato të mbajtura nga subjekte politike dhe kur nuk është parë ndërhyrja e FLO.

Nëse ishte e domosdoshme dhe e diktuar nga një rrezik i shtuar ndërhyrja e forcave të armatosura brenda TK, institucioni i Avokatit të Popullit nuk mund të nxjerrë një përfundim objektiv për arsye se dokumentacioni dhe filmimet e kërkuara nuk na janë vënë në dispozicion nga DPPSH, me justifikimin se janë të klasifikuara “Sekret” dhe duhet të zbatohen procedurat e përcaktuara në ligj për njohjen e tyre. Në lidhje me këtë qëndrim, sjellim në vëmendje se, në bazë të nenit 20 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “*Për Avokatin e Popullit*”, i ndryshuar, *Avokati i Popullit ka të drejtë të kërkojë edhe informacione apo dokumente, që lidhen me çështjen në shqyrtim, të klasifikuara si sekret shtetëror. Në këto raste, ai është i detyruar të respektojë kërkesat për ruajtjen e sekretit shtetëror.* Disa nga punonjësit e institucionit tonë që po shqyrtojnë këtë çështje janë të pajisur me “Certifikatën e sigurimit të personelit” konform akteve normative që rregullojnë këtë çështje. Ndodhur në këto rrethana, refuzimi për të dërguar kopjen e dokumenteve me justifikimin se ato janë të klasifikuara “Sekret”, nuk është i bazuar në ligj.

Mbetemi në pritje të përfundimit të hetimit nga organi i prokurorisë për të kuptuar nëse ndërhyrja e FLO ka qenë e përligjur ose jo.

Mosvënia në dispozicion e pamjeve tregon se policia nuk është transparente dhe as pranon të ketë rishikim objektiv të situatës dhe veprimeve të kryera. Për më tepër shpjegimet e dhëna nga Policia e Shtetit bien në kundërshtim me deklaratën e Ministrisë të Brendshme të bëra publike në lidhje me pozicionimin dhe shkakun e pjesëmarrjes së Forcave Operacionale.

b) detyra për operacione policore të një shkalle të lartë vështirësie, të cilat nuk mund të përballohen nga shërbimet e tjera të Policisë së Shtetit.

- *Përdorimi i uniformës pa numër personal identifikimi*

Ajo që u vu re qartë në media ditën e kryerjes së ndërhyrjes te TK ishte mungesa e numrit të identifikimit në uniformën e një pjese të punonjësve të policisë. Vëmendja tek elementët e uniformës u tërhoq edhe nga disa qytetarë, të cilët u ankuan se punonjës të policisë kishin ushtruar dhunë fizike dhe verbale dhe se ata e kishin të pamundur identifikimin e tyre.

Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë i kërkua të na informonte nëse kishin marrë pjesë në operacionin në fjalë punonjës të policisë me uniformë pa numrat personalë të identifikimit.

Në përgjigjet e marra thuhet si vijon:

“Paraqitja e jashtme dhe uniforma e punonjësve të policisë të planizuar me shërbim ka qenë ajo e përcaktuar në Rregulloren e Uniformës së Policisë së Shtetit dhe Procedurën Standarde të Punës “Për mbajtjen dhe përdorimin e uniformës së Policisë së Shtetit” miratuar me Urdhrin nr.528, datë 28.05.2018, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

Ka pasur disa punonjës policie që nuk kanë qenë të pajisur me numrin personal të identifikimit për shkak sepse ky element i uniformës nuk është prodhuar për arsye objektive. Këtë mangësi për këtë element e kemi edhe në struktura të tjera të policisë, për të cilin po marrim masa për plotësimin sa më shpejt të jetë e mundur.”¹²

“Për sa i përket punonjësve të policisë pa numër personal, ju bëjmë me dije se edhe aktualisht kemi punonjës policie të pa pajisur me numra, kjo për mungesë logjistike, por paraqitja edhe uniforma e punonjësve të policisë të planizuar për mbështetje gjatë ekzekutimit të vendimit nga IMT-ja në prishjen e objektit të teatrit, ka qenë ajo e përcaktuar në Procedurën Standarde për mbajtjen dhe përdorimin e uniformës së Policisë së Shtetit Nr. 528, datë 28.05.2018, uniforma policisë ka qenë e dukshme dhe mbi të gjitha i dallueshëm lehtësisht nga qytetarët.”¹³

Uniforma dhe shenjat dalluese janë pjesë e pandashme e figurës së punonjësit të Policisë së Shtetit dhe legjislacioni në fuqi parashikon një sërë rregullash për paraqitjen dhe

¹² Shkresa me Nr. 3274/1 Prot., datë 18.06.2020 e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

¹³ Shkresa me Nr.4952/1 Prot., datë 16.07.2020 e Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë.

mbajtjen e tyre¹⁴. Një nga elementët që duhet të mbajë uniforma e punonjësit të policisë është numri i identifikimit¹⁵.

Uniforma e policisë nuk është vetëm një veshje funksionale, ajo shërben edhe si simbol i pushtetit publik, për të ngjallur ndjenjën e sigurisë dhe kompetencës tek qytetarët. Prirja e krijuar në popullatë është që punonjësit e policisë me uniformën standard të shihen si më miqësorë dhe të besueshëm se ata që përdorin uniformë me motive kamuflazhi apo me një shfaqje luftarake. Ka një arsye jo të pabazuar për të besuar se, mbulimi i fytyrës me maskë operationale apo me helmetë dhe mungesa e shenjave dalluese i shtyn punonjësit e policisë të kryejnë veprime të dhunshme, në tejkalim të detyrës së tyre. Kjo shtysë vjen nga fakti i vështirësisë për të identifikuar punonjësin që ka vepruar në kundërshtim me ligjin apo urdhrat që ka marrë dhe për rrjedhojë edhe shmangia e tij nga përgjegjësia. Zgjedhja e drejtuesve të Policisë së Shtetit për të dërguar në fillim të ndërhyrjes te TK punonjës të forcave operationale, me maskë dhe armë zjarri, punonjës të forcave shqiponja që mbanin në kokë helmetën e motorrit si dhe mungesa e numrit të identifikimit

¹⁴ - Në nenin 98 “Uniforma dhe shenjat dalluese” të Ligjit Nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, parashikohet:

1. Punonjësi i policisë i kryen detyrat për ruajtjen e rendit dhe të sigurisë publike me uniformën dhe shenjat e përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave. Uniforma dhe shenjat dalluese të policisë përdoren vetëm gjatë shërbimit ose për shkak të tij. Struktura të veçanta të policisë trajtohen me veshje civile ose kompensim financiar.

2. Punonjësi i policisë pajiset me dokumentin dhe medaljonin zyrtar të identitetit, të cilat i paraqet në çdo rast të kryerjes së detyrës. Forma, përmasat dhe të dhënat që përmban dokumenti identifikues dhe medaljoni zyrtar i identitetit përcaktohen në Rregulloren e Policisë.

- Ndërsa, në nenin 37 të VKM Nr. 750, datë 16.09.2015 “Për miratimin e rregullores së Policisë së Shtetit” parashikohet:

1. Përdorimi i uniformës përbën prezantimin publik të Policisë së Shtetit.

2. Kanë të drejtë të përdorin dhe veshin uniformën e Policisë së Shtetit vetëm punonjësit e Policisë që kanë gradë policore.

3. Përdorimi i rregullt i uniformës është detyrë e të gjithë punonjësve të Policisë së Shtetit. Rregullat për mbajtjen dhe përdorimin e uniformës përcaktohen në procedurat standarde të punës.

4. Si rregull, drejtorët e drejtorive qendrore, drejtorët e drejtorive vendore të Policisë, drejtorët e strukturave vendore të kufirit dhe migracionit, shefat e komisarivateve të Policisë, komandantët e strukturave të veçanta, shefat e stacioneve, komandantët e postave të Policisë, si dhe punonjësit e Policisë që zëvendësojnë punonjësit e sipërpërmendur, mbajnë uniformë policie gjatë kohës së punës/shërbimit.

5. Në rast se punonjësit e strukturave qendrore dhe vendore për hetimin krimeve do të kryejnë detyra në publik pa uniformë policie, ata janë të detyruar të identifikohen si punonjës të Policisë së Shtetit, sipas rregullave të përcaktuara për këtë qëllim.

6. Punonjësve të Policisë u ndalohe

a) të përdorin veshje policore të policive të vendeve të tjera;

b) të heqin simbolet, emblemën, gradat, stemat sipas shërbimeve të Policisë, shenjat dalluese etj. nga uniformat që kanë në përdorim;

c) të modifikojnë pjesë të veshjes policore;

ç) të përdorin simbolet, emblemën, gradat, stemat sipas shërbimeve të Policisë, shenjat dalluese etj., të pa miratuara për veshjen policore.

¹⁵ Në VKM Nr.55, datë 27.01.2016 “Për miratimin e paraqitjes, formës dhe specifikimeve teknike të gradave, simboleve, uniformave dhe shenjave të Policisë së Shtetit”, përcaktohet se:

5. Shenjat dalluese të Policisë së Shtetit janë:

5.1 Shenja e mbiemrit/numri identifikimit

8. Gradat, simbolet, uniformat dhe shenjat e Policisë së Shtetit, të miratuara sipas këtij vendimi, për nga qëllimi i përdorimit, janë pronë e Drejtorisë së Policisë së Shtetit dhe përdoren vetëm gjatë shërbimit ose përshkak të tij nga punonjësit e Policisë së Shtetit.

9. Gradat, simbolet, uniformat dhe shenjat e Policisë së Shtetit janë të patjetërsueshme. Ndalohet shumëfishimi dhe realizimi i modeleve e ngjyrave të tyre për përdorues të institucioneve apo subjekteve të tjera që trajtohen me uniformë, të cilat nuk kanë të njëjtin mision dhe detyra që ka Policia e Shtetit.

në uniformë krijoi imazhin e një policie të prirur për të dhënë një spektakël force, i panevojshëm pavarësisht fryrjes së rrezikut të pritshëm që u bë në media. Kjo qasje vë në provë të vështirë marrëdhënien midis policisë dhe komunitetit.

Policia e Shtetit në përgjigje të kërkesës tonë, nuk ka dhënë shpjegime për arsyen objektive që ka çuar në mungesën e elementit të identifikimit në uniformën e punonjësve të Policisë së Shtetit, por është mjaftuar vetëm me konstatimin e faktit dhe premtimin se po merren masa për plotësimin sa më shpejt të jetë e mundur. Ne vlerësojmë se ky qëndrim nuk mund të jetë në asnjë rast justifikues për shkelje të ligjit, si dhe për uljen e garancive për zbatimin e ligjit për shtetasit.

Për të shmangur problemet që lidhen me këtë element formal dhe për të treguar transparencë me publikun, rekomandojmë që nga strukturat përkatëse të Policisë së Shtetit të bëhet një analizë e thelluar, duke trajtuar sa vijon: Sa është numri i përgjithshëm i punonjësve të Policisë së Shtetit që veprojnë pa numër identifikimi dhe prej sa kohësh? Në cilat shërbime? A po trajtohet me prioritet zgjidhja e kësaj çështjeje? (psh prokurimi në mënyrë të përsheptuar vetëm për numrat e identifikimit, apo veçimi i këtij tenderi nga tenderat e tjerë), A duhet planifikuar ndonjë rradhë veprimi? (psh prioritare paisja me numër identifikimi e punonjësve të terrenit dhe më pas e atyre në zyra); A ka nevojë për zgjidhje provizore? (psh mundësia e çvendosjes së numrave të identifikimit, nga uniformat e mëparshme, në ato aktuale), etj.

Në përfundim të analizës së mësipërme, rekomandojmë që qëndrimet e Policisë së Shtetit, të bëhen publike për këtë çështje dhe në rast se rezultojnë punonjës përgjegjës për shkaktimin e kësaj situate, ndaj tyre të merren masat përkatëse.

Në se çështjes së mungesës së numrave të identifikimit, i shtohen edhe pretendimet për klasifikimin sekret të pamjeve filmike, apo edhe deklarata e Ministrit të Brendshëm¹⁶ arrijmë në konkluzionin se ka munguar vullneti për të hedhur dritë në mënyrë të gjithanshme, në lidhje me veprime eventuale në tejkallim të forcës në rastin konkret. Nga analiza e këtyre fakteve në përgjithësi, është e dukshme se në rastin në fjalë, nuk plotësohet parimi që duhet të udhëheqë drejtuesit e lartë shtetërorë, në lidhje me ushtrimin e forcës tej kufijve të lejuar, e konkretisht zero tolerancë ndaj veprimeve arbitrare¹⁷.

- Ankesat për ushtrim dhune fizike dhe verbale

Ankesa më e rëndë ndaj punonjësve të Policisë së Shtetit ishte ajo e ushtrimit të dhunës fizike dhe verbale gjatë këtij operacioni. Ankesat u ngritën si në media, ashtu edhe para

¹⁶ Intervistë në emisionin Java në RTSH në datën 22 Maj 2020.

<https://ms-my.facebook.com/lleshajander/posts/583545565628109/>

<https://www.facebook.com/373629189737901/posts/943133119454169/>

¹⁷ Në Raportin e Komitetit European për Parandalimin e Torturës, Trajtimin ose Dënimit Çnjerëzor ose Poshtëruar (CPT) të Këshillit të Evropës, i bërë publik në datën 17.09.2019, është rekomanduar që autoritetet shqiptare duhet të dyfishojnë përpjekjet e tyre për të luftuar keqtrajtimin nga punonjësit e policisë. Në veçanti, duhet t'u sillen në vëmendje punonjësve të policisë se të gjitha format e keqtrajtimin (përfshirë dhunën verbale) janë të paligjshme dhe do të dënohen në përputhje me rrethanat.

Për më tepër, në pjesën e raportit që ka të bëjë me Policinë e Shtetit, shkronja "A. Ndalimi nga Policia 2. Keqtrajtimi", në pikën 14 të tij, shprehet se *është thelbësore të sigurohet që punonjësit e policisë në të gjitha nivelet të jenë të vetëdijshëm se qeveria është e vendosur të pengojë keqtrajtimin e personave të privuar nga liria duke forcuar përgjegjshmërinë e policisë dhe duke hetuar në mënyrë efektive pretendimet për keqtrajtim*".

Për më shumë shih:

<https://www.coe.int/en/web/cpt/-/council-of-europe-anti-torture-committee-publishes-report-on-alban-3>

punonjësve të Institucionit të Avokatit të Popullit, të cilët kanë marrë me shkrim dëshmitë përkatëse. Dhuna pretendohet se ka ndodhur në çastet e para të ndërhyrjes së punonjësve të policisë për të larguar qytetarët nga TK, në makinë gjatë shoqërimit për në ambientet e policisë të disa prej tyre, dhe gjatë protestës që ka pasuar shembjen e godinës së TK. Përveç ankesave të regjistruara në institucionin tonë, kemi marrë në shqyrtim edhe disa raste të shfaqura në media. Ajo që është evidentuar në disa raste është se punonjësit e policisë kanë tentuar të mënjanojnë filmimin e veprimeve nga operatorët e medias dhe kanë shoqëruar ndonjë prej tyre.

Nga praktika e deritanishme, vlerësojmë se pretendimet për ushtrim dhune, veçanërisht të dhunës verbale, nuk janë të lehta për t'u provuar. Fjalët kërcënuese nuk regjistrohen, goditjet mund të mos lenë gjurmë, edhe nëse vihen re shenja në trupin e ankuesit duhet të kuptohet si dhe kur janë shkaktuar ato, a kemi të bëjmë me forcë të ligjëruar të ushtruar nga punonjësi i policisë e diktuar nga qëndrimi i ankuesit apo ka patur tejkalim të forcës nga pakujdesia apo me dashje.

Ankesat që regjistrohen në Institucionin e Avokatit të Popullit nuk merren të mirëqena, ato i nënshtrohen një procesi verifikimi. Për rastet e dhunës merren deklarime me shkrim, të cilat duhet të kenë të dhëna që ndihmojnë zbardhjen e të vërtetës dhe jo vetëm shpjegime të përgjithshme, administrohen pamje video/audio, dokumente, foto si dhe mund të kërkohet ekspertimi mjeko-ligjor. Procesi i të provuarit në Institucionin e Avokatit të Popullit ka elementë të ngjashëm me atë që kryen organi i prokurorisë, por me disa kufizime në mundësinë e sigurimit të provave. Në përfundim të hetimit administrativ, i gjithë materiali i mbledhur analizohet dhe nëse provohet pretendimi i ankuesit për dhunë, në varësi të rrethanave dhe lëndimit të shkaktuar nxjerrim rekomandime për dhënien e masave disiplinore ose fillimin e hetimit penal nga prokuroria.

Policia e Shtetit ka raportuar se gjatë ekzekutimit të vendimit për prishjen e godinës së Teatrit Kombëtar dhe më pas, qytetarë të ndryshëm janë grumbulluar në kundërshtim me kërkesat e Aktit normativ, i cili ndalon në situatë pandemie grumbullime dhe protesta, ata kanë kundërshtuar veprimet e punonjësve të IMT, kanë protestuar duke shtyrë me forcë kordonin e policisë, goditur me sende të forta, gurë dhe kapsolla punonjësit e policisë si dhe kanë bllokuar rrugët pranë vendit të ekzekutimit të vendimit. Sigurisht që nuk është e lehtë të kërkosh që qytetarët të zbatojnë detyrimin e mosmbledhjes në grupime masive kur vetë ky rregull nuk konsiderohet nga disa organe shtetërore e gjegjësisht IMT, Policia Bashkiake, Policia e Shtetit. Ndaj disa qytetarëve janë dhënë masa administrative me gjobë për shkelje të Aktit normativ Nr.3, datë 15.03.2020 që ka të bëjë me kufizimet gjatë pandemisë dhe ndaj disa të tjerëve janë përcjellë materialet në prokurori për kryerje të veprave penale “Organizimi, pjesëmarrja, grumbullimi dhe manifestimi i paligjshëm”, “Kundërshtimi i punonjësit të policisë së rendit publik” dhe “Mosbindja ndaj urdhrat të punonjësit të policisë së rendit publik”.

Edhe nga pamjet e shfaqura në media janë vënë re qytetarë të zemëruar, të cilët kanë bërë qëndrësë aktive dhe pasive ndaj punonjësve të policisë. Punonjësit e Policisë kanë ushtruar forcë për të larguar qytetarët nga TK dhe për të mos lejuar protestuesit të kalojnë perimetrin e sigurisë të vendosur rreth vendit ku do të vepronte IMT Bashkia Tiranë.

Për të vlerësuar forcën e ushtruar nga punonjësit e policisë në proporcion me shkallën e rrezikshmërisë dhe a është përdorur prej tyre fjalor joetik ndaj qytetarëve dhe ndaj të

shoqëruarve, po parashtrojmë rregullat që përcakton legjislacioni për përdorimin e forcës dhe etikën e sjelljes së punonjësve të policisë.

Në Ligjin Nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, nenet 101,102 dhe 103 parashikohen masat për ruajtjen e rendit dhe sigurisë publike sipas të cilave, kur sjellja e një personi cenon rendin dhe sigurinë publike, punonjësi i policisë, në zbatim të përgjegjësive të tij dhe në përputhje me ligjin, merr masa për shmangien e rrezikut për shtetasin dhe veten si dhe vlerëson nëse është e nevojshme marrja e masave shtesë ose dhënia e ndihmës dhe njofton menjëherë autoritetet përgjegjëse administrative. Po ashtu, përcaktohet se “masa për të shmangur rrezikun duhet të jetë në proporcion me shkallën e rrezikshmërisë, të drejtat dhe interesat që vihen në rrezik dhe/ose cenohen, si dhe nuk duhet të përbëjë kapërcim të kufijve të nevojës për situatën e paraqitur. Vetëm nëse kjo masë është e paefektshme, atëherë mund të zgjidhet një masë tjetër proporcionale me ndikim më të madh. Zbatimi i mëtejshëm i çdo mase të ndërmarrë ndërpritet menjëherë kur shkak i saj nuk ekziston më. Ndërsa, zbatimi i masës së menjëhershme merret vetëm nëse duhet mënjanuar një rrezik real dhe i çastit për rendin dhe sigurinë publike, i cili nuk mund të shmanget me anë të mjeteve të tjera duke njoftuar menjëherë personin ndaj të cilit ajo ndërmerret”.

Sa i përket përdorimit të forcës, i referohemi nenit 133 të ligjit të sipërpërmendur sipas të cilit:

1. Punonjësi i policisë përdor forcën për të përmbushur detyrën vetëm kur kjo është e nevojshme dhe vetëm nëse të gjitha masat e tjera janë të pasuksesshme apo të pamundura.
2. Punonjësi i policisë përdor forcën në përputhje me parimin e proporcionalitetit.
3. Punonjësi i policisë përzgjedh nivelin e nevojshëm të forcës ndërmjet mundësive të përshkallëzuara, që, ndër të tjera, përfshijnë bindje me fjalë, shtrëngim fizik, mjete goditëse, mjete me lëndë paralizuese, mjete me goditje elektrike, qen policie dhe armë zjarri.
4. Të dëmtuarit i jepet ndihmë, ku përfshihet edhe ajo mjekësore, pas përdorimit të forcës, në rast se kjo është e nevojshme dhe e mundur.
5. Punonjësi i policisë duhet të paralajmërojë se do të përdorë forcën para përdorimit të saj. Ky paralajmërim mund të mos kryhet nëse rrethanat nuk e lejojnë, veçanërisht kur përdorimi i menjëhershëm i forcës është i nevojshëm për të parandaluar një rrezik real dhe të çastit.
6. Grupe personash paralajmërohen sa më shpejt të jetë e mundur se do të përdoret forcë ose forma e forcës së përdorur do të ndryshohet, në mënyrë që pjesëmarrësit të lejohen të largohen.

Ndërsa në VKM Nr.750, datë 16.09.2015 “Për miratimin e Rregullores së Policisë së Shtetit”, përkatësisht nenet 110 dhe 211, përcaktohet si më poshtë:

Neni 110

1. Punonjësi i Policisë përdor forcën vetëm kur është në mënyrë të arsyeshme e nevojshme dhe vetëm në masën që kërkohet për të arritur një synim të ligjshëm.
2. Punonjësi i Policisë, në çdo rast e përdor forcën pa cenuar thelbin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe përdor gjithmonë mjete të përshtatshme në proporcion me rrezikun dhe qëllimet që synohen të arrihen.

3. *Punonjësi i Policisë është përgjegjës individualisht për ushtrimin e forcës dhe jep llogari para ligjit.*

Neni 211

Punonjësi është përgjegjës për përdorim të paligjshëm dhe të paarsyeshëm të forcës, nëse:

- 1. përdor forcën në intensitet dhe kohë, mbi masën që është e domosdoshme për të arritur objektivin legjitim dhe të ligjshëm të Policisë;*
- 2. përdor forcën, e cila nuk është proporcionale me shkallën e kërcënimit dhe nuk është e balancuar me nevojën për të zvogëluar shkaktimin e viktimave civile, dëmet e pasurisë, si dhe ambientin natyror;*
- 3. përdor mjetet për përdorimin e forcës në kundërshtim me ligjin dhe aktet nënligjore të Policisë.*

Po kështu në këtë akt nënligjor parashikohen standardet dhe normat e sjelljes së punonjësve të policisë. Sipas këtyre standardeve¹⁸, *punonjësi i policisë vepron i udhëhequr nga vetëkontrolli dhe toleranca, duke trajtuar publikun dhe kolegët me respekt dhe mirësjellje. Ai ushtron përgjegjësitë në proporcion me situatën, në përputhje me ligjin dhe në respekt të të drejtave të njeriut dhe të sigurohet që sjellja dhe fjalori i përdorur nga ana e tij, të mos perceptohen si abuzive, ofenduese, ngacmuese, tallëse apo viktimizuese duke respektuar dinjitetin e gjithsecilit*

Në rastet që do rendisim dhe analizojmë më poshtë çojmë se ka patur përdorim të paarsyeshëm të forcës nga ana e disa punonjësve të policisë.

Menduh Zavalani, aktivist për mbrojtjen e TK, me profesion arkitekt, ka deklaruar se në orën 04:30 të mëngjesit të datës 17 maj 2020, ndodhej në sheshin mes Teatrit Kombëtar dhe Teatrit Eksperimental, ku kishin mbetur rreth 25 vetë, duke përfshirë dhe disa gazetarë dhe kameramanë. Në këtë kohë ka dëgjuar një prej të pranishmëve në shesh të thotë “*Erdhën! Erdhën!*”. Pranë hyrjes së Teatrit Kombëtar ka parë një furgon pa drita, nga dera anësore e të cilit, kanë dalë me shpejtësi një grup burrash me maska që nisën të vrapojnë duke bërë drejt hyrjes anësore të TK. Trupat me maska kanë ardhur në befasi duke bastisur hyrjen anësore dhe duke ushtruar terror me të bërtitura kërcënuese. Kur ndodhej përballë trupave me maska që po ushtronin dhunë verbale dhe fizike ndaj aktivistëve që ndodheshin aty pranë ai ka filluar të filmojë me aparatën celular. Trupat me maska i janë dukur si forca speciale policore. Ata nuk mbanin asnjë emër ose identitet të shkruar përpara, përveç fjalës “Policia” në kurriz. Disa prej tyre janë futur në sallën e TK. Një tjetër, i ndodhur përballë tij, ka kapur një vajzë shtatshkurtër duke e shkundur në kërcënim. Kjo trupë me maska e ndodhur jashtë TK ka shtyrë dhe goditur disa aktivistë, ka përdorur sprajt drejt fytyrave të mbështetësve të teatrit. Sprajti e ka kapur edhe atë duke e detyruar të largohet për të rregulluar frymëmarrjen. Duke ecur në drejtim të një personi të dëmtuar, trupa policore e ka shtyrë nga pas. Aty është goditur fillimisht anash dhe ka bërë instiktivisht. Papritur ka marrë disa goditje shumë të forta në majë të kokës, në vesh dhe i ranë syzet, në fytyrë, në qafë, në brinjë e kurriz, duke e detyruar të kërruset. Në këtë çast ka humbur syzet optike dhe nuk mund të shihte. Më tej është futur në një furgon, ku i ka kërkuar një të shoqëruari tjetër që ndodhej aty të fotografonte me celular lëndimet në vesh dhe buzë. Punonjësi i Policisë që i ka vënë re e ka goditur me grusht në kokë duke përdorur edhe dhunë verbale. Pas mbërritjes në Komisariatin e Policisë nr.3 është dërguar në

¹⁸ Nenet 115 dhe 117 të VKM Nr.750, datë 16.09.2015 “Për miratimin e Rregullores së Policisë së Shtetit”.

Spitalin e Traumës me autoambulancë ku është kontrolluar nga një mjek, ka bërë një grafi të kraharorit dhe skaner të gjithë trupit. Pas skanerit i është konfirmuar verbalisht se kishte shembje në kokë, në kraharor dhe në trup, por jo nevojë për ndërhyrje. Mjeku i ka rekomanduar të trajtohet me antibiotikë dhe barna qetësuese. Një infermier i ka qepur plagën në vesh dhe i ka bërë injeksion tetanozi. Kur është kthyer në komisariat, oficeri i policisë gjyqësore i ka dhënë një vendim për të kryer ekspertim mjeko-ligjor. (Deklarimi i këtij shtetasi është dhënë në mënyrë të përmbledhur)

Për verifikimin e ankesës së paraqitur nga shtetasi Menduh Zavalani kemi këqyrrur pamjet e shfaqura në media ku janë fiksuar disa nga çastet e përshkruara më lart, pamjet që ka xhiruar vetë ankuesi, fotot e lëndimeve që ai ka shkrepur pas shoqërimit, është administruar akt ekspertimi mjeko-ligjor dhe formulari i raportit të shoqërimit.

Në pamjet filmike të medias dallohet çasti kur punonjës të policisë me veshje të zezë dhe maska operacionale mësyjnë drejt TK dhe bëhen gardh para njëres prej dyerve hyrëse të godinës. Shtetasi Menduh Zavalani, i veshur me xhup jelek ngjyrë portokalli të çelët, bluzë të kuqe me mëngë të shkurtra dhe pantallona në ngjyrë të errët ndodhet rreth një metër larg punonjësve duke filmuar me aparat celular. Në fytyrë duket të mbajë syze optike. Përreth tij, jo shumë larg njëri-tjetrit ndodhen edhe 6 shtetas të tjerë, të cilët vështrojnë të çoroditur. Nga brenda godinës nxirret një djalë që mban duart lart. Një punonjës i policisë spërkat me sprajt në drejtim të dy vajzave që gjenden para gardhit policor. Mediat nuk kanë shfaqur se çfarë ndodh më pas. Në këtë situatë, në ndihmë na vjen filmimi i vetë ankuesit, i cili ka fiksuar më nga afër këtë çast edhe me zë. Pasi punonjësi i policisë spërkat me sprajt dhe disa të tjerë bëjnë thirrje “largohuni”, ankuesi tërhiqet disa metra larg duke u kollitur. Ndërkohë vazhdon të filmojë. Para derës anësore të TK afrohen punonjës të tjerë të policisë që shpërndahen në drejtime të ndryshme duke thënë “pastroje vendin”. Aktivistë për mbrojtjen e TK janë larguar dhe situata duket e qetë. Këtu ndërpritet filmimi i ankuesit. Pamjet që na sigurojnë mediat për atë që ka ndodhur më pas janë të një momenti të dytë, jo larg në kohë me të parin. Një numër jo i vogël punonjësish të forcës “Shqiponja”, me helmeta motorri në kokë, po largojnë me forcë disa persona. Shtetasi Menduh Zavalani duket i rrethuar nga dhjetëra punonjës të policisë, kryesisht të forcës “Shqiponja”, të cilët e tërheqin me forcë. Këto janë të vetmet pamje që kemi mundur të administrojmë për të kuptuar dinamikën e ngjarjes.

Shtetasi Menduh Zavalani është shoqëruar në Komisaratin e Policisë nr.3. Punonjësi i forcës shqiponja që ka plotësuar formularin e raportit të shoqërimit ka shënuar se ky shtetas është shoqëruar për llogari të FNSH-së, por nuk ka dhënë shpjegime për arsyen e shoqërimit. Komisioni i Shqyrtimit të Kundërvajtjeve Administrative pranë Komisaratin të Policisë Nr.3, me vendimin nr.339, datë 18.06.2020, ka vendosur ndaj këtij shtetasi masën administrative gjobë, për shkelje të rregullave në kohën e pandemisë. Referuar informacionit të dhënë nga Komisarati i Policisë Nr.3, shtetasi Menduh Zavalani është proceduar në gjendje të lirë për veprën penale “Kundërshtimi i punonjësve të policisë” dhe “Organizimi dhe pjesëmarrja në tubime të paligjshme”.

Sipas kërkesës së bërë nga oficeri i policisë gjyqësore, mjeku ligjor ka ekzaminuar shtetasin Menduh Zavalani duke marrë parasysht edhe të dhënat e marra nga Spitali Universitar i Traumës Tiranë. Mjeku ligjor ka arritur në përfundimin se: në trupin e shtetasit Menduh Zavalani janë vënë re tronditje të trurit e shkallës së parë, dermishtje, ekimoza me lokalizime në kapakun e sipërm të syrit të majtë, në llapën e veshit të djathtë, në pjesën e jashtme të kanalit të veshit, në krahun e djathtë dhe të majtë, në pjesën e

jashtme të kërcirrit të djathtë. Këto dëmtime janë shkaktuar me mjet mprehtës. Dëmtimet futen në kategorinë e dëmtimeve që shkaktojnë humbje të aftësisë për punë në masën mbi nëntë ditë.

Në përfundim të analizimit në tërësi të materialit të mbledhur vlerësojmë se ndaj shtetasit Menduh Zavalani është përdorur forcë e paarsyeshme. Pamjet tregojnë se situata në TK, kur ka nisur ndërhyrja e Policisë së Shtetit, ka qenë pothuajse e qetë. Ata pak aktivistë që qendronin brenda dhe jashtë TK duken të çoroditur dhe të tulatur dhe sillen rrotull si të mpirë, të rrethuar nga numër i madh forcash të policisë. Përshkrimi i ngjarjes së dhënë nga shtetasi Menduh Zavalani në deklarimin e tij përputhet me dinamikën e ngjarjes që shfaqet në pamjet që kemi administruar. Ai nuk kryen asnjë veprim që mund të përbëjë rrezik për punonjësit e policisë dhe nuk shfaqet i dhunshëm. Largohet nga gardhi i vendosur nga forcat e policisë para derës së TK kur i kërkohet dhe nuk dëgjohej të bëjë thirrje për qëndresë. Është e vështirë të besohet se si një person me karakteristikat fizike të shtetasit Menduh Zavalani, i vetëm, të përbente rrezik për punonjësit e policisë në mënyrë që të përlligjen lëndimet e shkaktuara nga forca e ushtruar. Në pamje duket qartë se ai nuk bën rezistencë kur gjendet i rrethuar nga dhjetëra punonjës të policisë, të cilët nuk mund të identifikohen pasi mbajnë në kokë helmata motorri dhe maskë operationale.

Maltin Grabovaj aktivist për mbrojtjen e TK, me profesion arkitekt, ka deklaruar se, në datën 17.05.2020, rreth orës 12:00 ka qenë tek protesta që zhvillohej tek Teatri Kombëtar, sepse ishte kundër prishjes së godinës. Tek kryqëzimi i Bulevardit "Dëshmorët e Kombit" me pedonalen, kur turma i është afruar kordonit të policisë dhe janë shtyrë me punonjësit e policisë, ai është gjendur ndërmjet protestuesve dhe policëve në pamundësi për t'u larguar. Punonjësit e policisë me veshje të repartit "Shqiponja" kanë filluar të kapin qytetarët që po shtyheshin me ta. M.Grabovaj ka qenë një ndër ta, i cili është tërhequr brenda kordonit policor ku rreth katër-pesë policë e kanë goditur me grushta, shpulla dhe shkelma. Nga goditjet ai është rrëzuar në tokë. Dy punonjës policie e kanë kufizuar me duart pas trupit ndërsa dy të tjerë kanë vazhduar ta godasin me grusht e shpulla në fytyrë e kokë. Më pas është prangosur dhe dërguar në Komisarlatin e Policisë Nr.1. Në datën 18.05.2020 Maltini ka kryer vizitë tek mjeku ORL në Spitalin Amerikan Nr.3. Pas ekzaminimit i është komunikuar se ka pësuar çarje të daulles së veshit të djathtë. (Deklarimi i këtij shtetasi është dhënë në mënyrë të përmbledhur).

Për verifikimin e ankesës së paraqitur nga shtetasi Maltin Grabovaj kemi kërkuar ekzaminimin e tij mjeko-ligjor si dhe është administruar formulari i raportit të shoqërimit. Për këtë rast nuk kemi disponuar pamje filmike që të kenë fiksuar veprimet e punonjësve të policisë.

Shtetasi Maltin Grabovaj është shoqëruar në Komisarlatin e Policisë nr.1. Punonjësi i policisë së këtij komisarlati që ka plotësuar formularin e raportit të shoqërimit ka shënuar se ky shtetas është ndaluar nga forca "Shqiponja" pasi ka marrë pjesë në tubim të paligjshëm. Ky shtetas është proceduar në gjendje të lirë.

Sipas kërkesës së bërë nga Institucioni i Avokatit të Popullit, mjeku ligjor ka ekzaminuar shtetasin Maltin Grabovaj duke marrë parasysh edhe të dhënat e marra nga Spitali Amerikan. Mjeku ligjor ka arritur në përfundimin se, në trupin e shtetasit Maltin Grabovaj janë vënë re çarje të membranës timpanike të djathtë dhe ekimoza në një të tretën e brendshme të krahut të djathtë dhe në këllkun e djathtë. Këto dëmtime janë shkaktuar me

mjet mprehtës. Dëmtimet hyjnë në katogorinë e dëmtimeve të humbjes së aftësisë së përkohshme për punë në masën mbi nëntë ditë.

Shtetasi Maltin Grabovaj është përfshirë në protestën që ka pasuar shembjen e TK. Për të siguruar perimetrin ku do të vepronte me mjete dhe punëtorë IMT Bashkia Tiranë, është krijuar një gardh policor. Në pjesën e Bulevardit “Dëshmorët e Kombit” përballë Ministrisë së Brendshme dhe Galerisë së Arteve janë grumbulluar dhjetëra qytetarë të zemëruar për prishjen e TK, të cilët kanë tentuar me forcë të çajnë gardhin policor. Maltin Grabovaj rrëfen se është ndodhur në një çast ndërmjet protestuesve dhe policisë pa mundur të largohet. Në mungesë të pamjeve filmike apo dëshmive të tjera nuk mund të kuptojmë nëse qëndrimi i shtetasit Maltin Grabovaj ka qenë pasiv gjatë protestës apo nëse ai ka kryer veprime të dhunshme ndaj punonjësve të policisë. Ajo që provohet me siguri nga kategoria e dëmtimit dhe vendi i dëmtimit është se ka patur tejkalim të forcës nga punonjësit e policisë. Shtrëngimi fizik që ushtron punonjësi i policisë ndaj një shtetasi (prangosja ose kufizimi me duar nga pas) kryhet me teknika të tilla për të arritur synimin e ligjshëm duke minimizuar shkaktimin e dëmtimeve trupore. Çarja e membranës timpatike tregon se ndaj tij është përdorur forcë e paarsyeshme. Maltin Grabovaj është me profesion arkitekt dhe i imët në trup. Kjo të bën të besosh se punonjësi ose punonjësit e policisë nuk janë ndodhur para një rreziku të atillë sa të detyroheshin të godisnin me forcë këtë shtetas në veshin e djathtë.

Alfred Lela, gazetar. Një episod nga protesta për TK që iu dha më zë në media ishte ai i gazetarit Alfred Lela. Pamjet filmike kanë dokumentuar qartë veprimet e tij dhe të punonjësve të policisë. Vetë Z. Lela nuk ka paraqitur ankesë në Institucionin e Avokatit të Popullit. Ankesën ai e ka bërë publike para mediave. Institucioni i Avokatit të Popullit, në zbatim të të drejtës së tij për të marrë në shqyrtim edhe raste me nismën e tij, kur ato janë bërë publike, ka analizuar veprimet e punonjësve të policisë me Z. Lela.

Gazetari Lela ka qenë i pranishëm në protestën që ka pasuar shembjen e TK. Pamjet tregojnë gazetarin Lela, i cili bashkë me disa qytetarë të tjerë qëndron pas kangjellave që ka vendosur bashkia në krah të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për të ndarë rrugën e këmbësorëve nga ajo e makinave. Në këtë çast, tre punonjëse të policisë mbajnë nga duart një shtetase në rrugën e makinave. Gazetari Lela kapërcen kangjellat dhe i afrohet punonjësve të policisë, kap nga duart një të tjetër prej tyre dhe i drejtohet me fjalë. Menjëherë mbrapa tij vijnë një punonjës policie me uniformë dhe dy të veshur civilë, të cilët e kapin me forcë nga qafa gazetarin Lela, e tërheqin në drejtim të Ministrisë së Brendshme dhe e hedhin fluturimthi mbi kangjellat duke e shembur në tokë ku edhe prangoset. Edhe në këtë rast i referohemi parimit të proporcionalitetit kur përdoret forcë. Masa për të shmangur rrezikun duhet të jetë në proporcion me shkallën e rrezikshmërisë, të drejtat dhe interesat që vihen në rrezik dhe/ose cenohen, si dhe nuk duhet të përbëjë kapërcim të kufijve të nevojës për situatën e paraqitur. Pamjet tregojnë qartë se veprimet e gazetarit Lela dhe rrethanat e këtij çasti nuk paraqisnin rrezikshmëri për punonjësit e policisë sa të justifikonin marrjen e tij me forcë duke e shtrënguar në qafë dhe mandej duke e shembur në tokë.

Një qytetar i pa identifikuar. Një rast tjetër i përdorimit të paligjshëm të forcës i bërë publik në media, i cili mendojmë se nuk ka nevojë për analizë të shtjelluar ligjore, është ai i një shtetasi që goditet me shkelm në kraharor nga një punonjës policie me maskë ndërkohë që gjendet i shtrirë kruspull përdhe duke mbrojtur fytyrën me duar dhe i rrethuar

nga një gardh policësh të tjerë. Pamjet kanë qarkulluar në internet dhe janë administruar nga ana jonë¹⁹.

Përdorimi i sprajtit. Në pamjet filmike që kemi administruar janë fiksuar dy raste të përdorimit të sprajtit nga punonjësit e policisë.

Rasti i parë është ai kur punonjësit e policisë me veshje të zezë dhe maskë mësyjnë menatë në godinën e TK dhe bëhen gardh para derës anësore. Para tyre ndodhen 7 shtetas, të cilët vështrojnë të çoroditur. Një punonjës i policisë spërkat me sprajt në drejtim të dy vajzave që gjenden më pranë tij. Njëra prej vajzave po mban në dorë celularin ndërsa tjetra qëndron mbështetur pas murit dhe duket e frikësuar. Në këtë çast afrohen katër qytetarë të tjerë. Edhe ndaj tyre hidhet sprajt.

Rasti i dytë i përdorimit të sprajtit ka ndodhur gjatë protestës që ka pasuar shembjen e TK. Një djalë, i cili nga një media vendase identifikohet si gazetar, por që nuk mban ndonjë mjet identifikimi si i tillë, drejtohet me një kamera të vogël në dorë në afërsi të disa punonjësve të policisë që po kufizojnë përdhe një qytetar përballë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë. Në këtë çast, një punonjës i veshur civil spërkat me sprajt në drejtim të djalit që po filmonte.

Bombola e sprajtit është një nga pajimet që mbajnë punonjësit e policisë. Edhe kur përdor sprajt, punonjësi i policisë duhet të ketë parasysh parimin e proporcionalitetit që zbatohet kur përdoret forcë fizike. Punonjësi i policisë përzgjedh nivelin e nevojshëm të forcës ndërmjet mundësive të përshkallëzuara, që, ndër të tjera, përfshijnë bindje me fjalë, shtrëngim fizik, mjete goditëse, mjete me lëndë paralizuese, mjete me goditje elektrike, qen policie dhe armë zjarri²⁰. Udhëzime të veçanta për përdorimin e sprajtit parashikohen në Urdhrin nr.92, datë 06.02.2015 “Përdorimi i lëndëve lakrimogjene” të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

Udhëzimet janë si vijon:

1. *Punonjësi i policisë sipas kompletimit organik gjatë kryerjes së shërbimit mban me vete bombolën e sprajtit (me piper ose gaz) në anën e krahut dominant me qëllim që në rast se sulmohet nga një person apo grup personash të dhunshëm ta nxjerrë e ta përdorë lehtësisht.*
2. *Punonjësi i policisë mund të përdorë bombolën (sprajtin) personal (armatim e pajisje në organikë) për vetëmbrojtje, pasi ka ezauruar më parë mjetet që përdoren sipas procedurës në rastet e përdorimit të forcës.*
3. *Ndalohet kategorikisht përdorimi i bombolave me gaz lakrimogjen në kundërshtim me rregullat e pa shkaqe të përlegjura, për lojë në ambiente të mbyllura (makinë me kolegët, në dhomat e shoqërimit dhe vende të ngjashme të kësaj natyre).*
4. *Në rast sulmi të dhunshëm e të befasishëm ndaj tij punonjësi i policisë e nxjerr shpejt dhe e drejton sprajtin në fytyrën e sulmuesit në distancë 30-60 cm me qëllim që të frenojë sulmin e të mposhtë rezistencën e personit që sulmon.*

¹⁹ <https://www.youtube.com/watch?v=wswLdLSwhV0>

²⁰ Neni 133/3 i ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”.

Në të dy rastet që kemi përshkruar më lart, vlerësojmë se punonjësi i policisë nuk është ndodhur para një rreziku të çastit dhe real. Punonjësit e policisë nuk kanë qenë të detyruar të vepronë për vetëmbrojtje. Rreth tyre nuk ndodheshin persona që t'u kanoseshin. Përdorimi i sprajtit ka qenë i nxituar dhe i paarsyeshëm.

Në përfundim të hetimit administrativ të këtyre rasteve dhe nga provat shkresore të administruara nga ana jonë sikurse janë: Deklarimet e shtetasve Menduh Zavalani dhe Maltin Grabova; Aktet e ekspertimit mjeko-ligjor të këtyre dy shtetasve, formulari i raportit të shoqërimit dhe CD-të me regjistrimet video/audio të bëra gjatë protestës nga ankuesit dhe media te ndryshme, vlerësojmë se, gjatë veprimeve në mbështetje të IMT të Bashkisë Tiranë gjatë prishjes së ish godinës së Teatrit Kombëtar nga disa punonjës të policisë janë konsumuar elementët e veprës penale të “Kryerjes së veprimeve arbitrare” në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 250 dhe 25 të Kodit Penal, të ndryshuar. Kjo mënyrë sjelljeje e punonjësve të policisë vjen në kundërshtim edhe me nenin 2 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, si dhe me nenin 94 të këtij ligji.

Dhuna verbale. Të paktën në një rast është provuar se punonjësit e policisë kanë përdorur fjalor fytes dhe jo etik ndaj personave të shoqëruar. Ashtu sikurse e kemi përmendur edhe më lart, një nga personat e shoqëruar në orët e para të mëngjesit, gjatë kohës që ndodhej në makinën e policisë ka regjistruar në fshehtësi fjalët e punonjësve që e kanë prangosur dhe shoqëruar. Nga biseda e regjistruar dëgjohen fjalët fyese të punonjësve të policisë, citojmë: “*Na lanë pa gjumë këta motër... lidhe qenin*” etj.

Kjo sjellje e punonjësve të policisë duke përdorur fjalë fyese ndaj qytetarëve protestues bie ndesh me dispozitat përkatëse ligjore dhe nënligjore të cilat normojnë veprimtarinë e Policisë së Shtetit dhe konkretisht me nenin 94²¹ dhe nenin 105²² të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”.

- *Teknika e kufizimit fizik*

Në orët e pasdrekës të ditës kur u shemb godina e TK, një grup të rinjsh u ul këmbëkryq në shenjë proteste në rrugën e automjeteve që kalon ndërmjet Parkut Rinia dhe Ministrisë së Financave duke bllokuar trafikun. Një nga punonjësit e policisë është afruar pranë të rinjve dhe është përpjekur me fjalë t'i bindë të lirojnë rrugën, por pa sukses. Atëherë janë afruar edhe punonjës të tjerë të policisë, të cilët kanë kapur me forcë disa të rinj duke i larguar në trotuar. Një nga të rinjtë që nuk ka pranuar të largohet ka bërë rezistencë pasive duke qendruar ulur dhe shtrirë në rrugë. Punonjësit e policisë e kanë kufizuar fizikisht me pranga me duar nga mbrapa shpine ndërkohë që i riu qëndronte përdhe. Kamera dhe aparati fotografik i mediave që raportonte ngjarjen ka fiksuar teknikën që ka përzgjedhur punonjësi i policisë për të ndihmuar kolegët që të kufizojnë më shpejtë dhe më lehtë të

²¹ Në nenin 94 të ligjit “Për Policinë e Shtetit”, parashikohet se:

“Punonjësi i Policisë është i detyruar të respektojë rregullat e sjelljes dhe etikës gjatë përmbushjes së detyrave”.

²² Në nenin 105 të ligjit “Për Policinë e Shtetit”, parashikohet se:

“Etika e Policisë së Shtetit përmban parimet dhe normat që rregullojnë raportet e sjelljes, qëndrimin, plotësimin të detyrave dhe komunikimit të punonjësit të Policisë për të vepruar në përputhje me ligjin, me standardet më të larta profesionale në mënyrë të drejtë, të paanshme dhe në respektim të dinjitetit njerëzor të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut”.

riun. Ai ka ushtruar presion me kërcirin e këmbës në kokën dhe qafën e djalit të vendosur me fytyrë përdhe.

Përdorimi i forcës është i pashmangshëm në punën e punonjësit të policisë. Ai mund të ndodhet në rrethana të tilla që rrezikojnë jetën e tij apo të një personi tjetër si dhe mund të ndeshet me rezistencë të dhunshme ose pasive. Kur punonjësi i policisë vendos të përdorë forcën duhet të ketë parasysh disa faktorë, si domosdoshmëria e përdorimit të forcës; shkalla e kërcënimit; masa e forcës; kohëzgjatja e saj. Përceptimi që ka secili punonjës për këto faktorë varet edhe nga përvoja e trajnimit të tij.

Kur kërkohet të vihet nën kontroll sjellja e një individi, intensiteti i forcës së ushtruar ndaj tij nuk duhet të jetë më shumë nga sa është e nevojshme dhe të minimizohen dëmet që mund t'i shkaktohen. Teknika e përdorur nga punonjësi i policisë në rastin e lartpërmendur jep mundësinë e neutralizimit të shpejtë të individit duke siguruar më mirë mbrojtjen nga një sulm i mundshëm i tij, por rreziku i dëmtimeve të individit është më i madh. Presioni i ushtruar në pjesë të trupit, si koka, qafa, diafragma etj., mund të shkaktojë dëme të përhershme ose mund të rezultojë fatale. Për këtë arsye kjo teknikë duhet të shmanget në raste si ai në fjalë ku nuk kishte një rrezik real dhe të çastit për punonjësit e policisë që po prangosnin të riun, rezistenca ishte pasive dhe protestuesit të pakët në numër rreth e përçark ishin të shpërndarë.

- *Mekanizmi i brendshëm në Policinë e Shtetit që mbikëqyr veprimtarinë e saj*

Përveç mbikëqyrjes së jashtme, legjislacioni parashikon mbikëqyrjen e veprimtarisë së Policisë së Shtetit edhe nga vetë struktura të saj. Përgjegjës për mbikëqyrjen në strukturat vendore është titullari i njësisë, ndërsa në nivel qendror është Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat (SHÇBA), në varësi të Ministrisë së Brendshme dhe Drejtoria e Standardeve Profesionale në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit. Këto struktura vihen në lëvizje nga shtetasit, punonjësit e policisë dhe me nismën e vet për rastet që bëhen publike.

Procedura e shqyrtimit të ankesave përcaktohet në Ligjin Nr. 70/2014 “Për shërbimin për çështjet e brendshme dhe ankesat në Ministrinë e Punëve të Brendshme” dhe në VKM Nr.750, datë 16.09.2015 “Për miratimin e Rregullores së Policisë së Shtetit”.

Nga ana jonë është kërkuar informacion në komisariatet e policisë nr.1, 2, 3, 4 dhe 6 në Tiranë, në Drejtorinë e Standardeve Profesionale dhe në SHÇBA nëse ishin regjistruar ankesa për punonjësit e policisë lidhur me ngjarjen tek TK dhe nëse ishin marrë në shqyrtim ato.

Komisariati i Policisë Nr.1 na ka kthyer përgjigje se, në regjistrin e evidentimit të të dhënave për personat e shoqëruar, shtetasit e shoqëruar në këtë komisariat kanë nënshkruar “se nuk kanë problem me punonjësit e policisë”. Në regjistrin e evidentimit, trajtimit dhe zgjidhjes së ankesave/kërkesave për personat e privuar nga liria nuk ka paraqitur ankesë asnjë shtetas.

Komisariati i Policisë nr.2 na ka kthyer përgjigje se, katër shtetasit e shoqëruar nuk kanë paraqitur asnjë ankesë në lidhje me shoqërimin e tyre në ambientet e këtij komisariati.

Ndërsa, Komisariati i Policisë nr.3 ndër të tjera, na informoi se, në regjistrin e evidentimit, trajtimit dhe zgjidhjes së ankesave/kërkesave për personat e privuar nga liria në ambientet e Policisë së Shtetit ka paraqitur ankesë vetëm shtetasi Menduh Zavalani. Shtetasi P. Xh. nuk ka nënshkruar ankesë në regjistrin përkatës. Specialistët për hetimin e krimeve që kanë marrë në pyetje këta shtetas u kanë dhënë vendim për kryerjen e ekspertimit mjeko ligjor në Institutin e Mjekësisë Ligjore. Pas kryerjes së veprimeve procedurale, shtetasit e mësipërm janë proceduar në gjendje të lirë. Në regjistrin e evidentimit të të dhënave për personat e shoqëruar kanë nënshkruar se nuk kanë probleme me punonjësit e policisë.

Komisariati i Policisë Nr.4 në përgjigjen e vet na vuri në dijeni se, të shoqëruarit në këtë komisarjat nuk kanë paraqitur asnjë ankesë dhe në deklaratimet që kanë dhënë janë shprehur se për punonjësit e policisë të Komisarjatisë të Policisë nr.4 nuk kanë pasur pretendim për mënyrën e veprimeve të tyre.

Sipas përgjigjes së Komisarjatisë të Policisë nr. 6, shtetasit e shoqëruar B. K. dhe M. Dh., në momentin e daljes nuk kanë shprehur as verbalisht dhe as me shkrim asnjë ankesë në drejtim të punonjësve të policisë.

Sa i përket Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat²³, mbi regjistrimin e ankesave për punonjësit e policisë na është dërguar informacioni si vijon:

“Drejtori i Përgjithshëm i SHÇBA-së, ka nxjerrë Urdhërin nr.48, datë 01.06.2020 “Për kryerjen e inspektimit në strukturat e Policisë së Shtetit”, me objekt: “Inspektim i veprimtarisë së strukturave të Policisë së Shtetit të angazhuar në mbështetje të IMT, Bashkia Tiranë më datë 17.05.2020 për prishjen e godinës së Teatrit Kombëtar, si dhe menaxhimin e protestave të zhvilluara nga Aleanca për Mbrojtjen e Teatrit, si dhe partitë opozitare në datat 17 – 22 Maj 2020”. Aktualisht ky inspektim është në proces dhe në përfundim do të hartohet raporti i inspektimit.

Për ngjarjen e datës 17.05.2020 Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë ka regjistruar procedimin penal nr.4115/2020 për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”. Në kuadër të këtij procedimi SHÇBA ka kryer disa veprime të deleguara nga prokuroria.

Aktualisht nga oficerët e policisë gjyqësore pranë Drejtorisë Rajonale të SHÇBA-së Tiranë janë duke u kryer veprimet e deleguara nga prokuroria për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës” dhe “Kryerja e veprimeve arbitrare”, parashikuar nga neni 248 dhe 250 të Kodit Penal dhe në përfundim do të përpilohet relacioni përkatës për prokurorinë.

Sa i përket veprimeve të Policisë së Shtetit në ambientet e TK më datë 17.05.2020 ju bëjmë me dije se deri në momentin aktual pranë SHÇBA nuk është paraqitur asnjë kallëzim penal ose ankim administrativ me këtë objekt”.

Ndërsa Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit²⁴ ka informuar se: “Në Drejtorinë e Standarteve Profesionale në rastin e bërë publik në media në datën 17.05.2020, lidhur me veprimet e punonjësve të Policisë së Shtetit, gjatë dhe pas operacionit për shembjen

²³ Shkresa nr.1214/1 Prot., datë 14.07.2020

²⁴ Shkresa Nr.1227/1 Prot., datë 04.09.2020

godinës së Teatrit Kombëtar, nuk janë paraqitur ankesa drejtpërdrejtë nga qytetarë apo në Portalin Bashkëqeverisja”.

Të dhënat e personit të shoqëruar në komisariatit e policisë shënohen në regjistrin e evidentimit të të dhënave për personat e shoqëruar. Ky regjistër është i ndarë në disa rubrika. Në rubrikën e fundit që plotësohet në çastin kur shtetasi lihet i lirë, ai nënshkruan dhe mund të shkruajë nëse ka pretendime për trajtimin e tij. Një dokument tjetër që plotësohet lidhur me personin e shoqëruar është procesverbali i veprimeve që kryhen me të. Procesverbali nënshkruhet në fund të çdo flete nga punonjësi i policisë që ka kryer veprimet dhe personi i shoqëruar. Një kopje e procesverbalit duhet t'i vihet në dispozicion personit të shoqëruar. Ky procesverbal plotësohet sipas një modeli të gatshëm prej një faqe dhe ka një pikë për ankesat dhe kërkesat lidhur me veprimet/sjelljet e policisë.

Pasi këqyrëm me vëmendje dokumentacionin që na u vu në dispozicion nga komisariatet e policisë rezultoi se, disa të shoqëruar, ndër to edhe shtetas që kanë paraqitur ankesë në Institucionin e Avokatit të Popullit dhe para mediave, kanë shkruar se *“nuk kanë pretendime në lidhje me sjelljen e punonjësve të policisë së komisariatit ku kanë qëndruar”* apo se *“nuk kanë pretendime me sjelljen e policies”*. Dy prej tyre, të pyetur nga ana jonë se pse në dokumentacionin e lartpërmendur kanë shënuar se nuk kanë pretendime dhe në ankesën e bërë tek ne kanë dëshmuar për dhunë fizike, na janë përgjigjur se punonjësi i policisë që i ka marrë në pyetje i ka thënë se pretendimet që shënohen në këto dokumenta kanë të bëjnë me trajtimin e tyre në komisariat. Si në këtë rast ashtu edhe në verifikime të tjera, të shoqëruarit shprehen se rubrikën e ankesave e plotësojnë me nxitim për arsye se dëshirojnë të dalin sa më parë pas gjithë situatës që kanë kaluar. Shembull tregues është ai shtetasit Menduh Zavalani, i shoqëruar për ngjarjen e TK në Komisararin e Policisë nr.3, i cili ka regjistruar ankesë në regjistrin e ankesave të këtij komisariati, ka bërë ankesë në Institucionin e Avokatit të Popullit, kallëzim në prokurori ndërsa në rubrikën e ankesave të *regjistrit të evidentimit të të dhënave për personat e shoqëruar* ka shënuar: *“nuk kam problem me punonjësit e policisë”*.

Ndryshe nga sa kanë referuar komisariatet e policisë, se të shoqëruarit nuk kanë paraqitur ankesa, përveç shtetasit Menduh Zavalani, rezulton se ka patur ankesa të tjera (bazuar në dokumentacionin e administruar).

Më konkretisht:

Shtetasi B. K. ka deklaruar para punonjësit të Komisarariatit të Policisë nr.6 që e ka intervistuar se: *“Dua të theksoj se ndaj meje shërbimet e policisë Shqiponja të cilët më shoqëruan kanë ushtruar dhunë fizike, verbale dhe psikologjike deri në momentin e shoqërimit tonë në ambientet e DVP Tiranë”*.

Shtetasi Alfred Lela, i shoqëruar në Komisarariatit e Policisë nr.1, ka shkruar në procesverbalin e veprimeve të kryera me të shoqëruarin: *“uniformat blu etike gjatë procesit, specialet të dhunshme dhe ofendues”*.

Për shtetasin D. Gj., i shoqëruar në Komisarariatit e Policisë nr.1, është shkruar në procesverbalin e veprimeve të kryera me të shoqëruarin se: *“gjatë shoqërimit pretendon se nuk i janë respektuar të drejtat themelore”*.

Për shtetasen Silva Caka, e shoqëruar në Komisarariatit e Policisë nr.4, është shkruar në procesverbalin e veprimeve të kryera me të shoqëruarin se: *“nuk ka pretendime për në komisariat, por për shoqërimin deri në komisariat”*.

Komisariatet e Policisë nuk kanë dhënë përgjigje si është proceduar për të verifikuar këto pretendime si dhe pretendimet e dy shtetasve për të cilët është marrë vendim për ekspertimin mjeko-ligjor.

Theksojmë se verifikimi ynë në Komisaratin e Policisë nr.4 përkoi me lirim të shtetasve të shoqëruar. Për të mos ndikuar në përgjigjen e tyre, ata u pyetën në përgjithësi nëse ju ishte dhënë ndonjë dokument para se të liroheshin. Të shoqëruarit treguan vetëm vendimin për masën administrative me gjobë që ju ishte dhënë. Procesverbali i veprimeve të kryera me personin e shoqëruar nuk ju ishte vënë në dispozicion. Të shoqëruarit në përgjithësi nuk kanë dijeni se ligji parashikon t'u jepet një kopje e procesverbalit të veprimeve të kryera me ta. Pjesa dërrmuese e tyre e nënshkruajnë këtë procesverbal pa i kushtuar vëmendje dhe pa lexuar në fund të saj se ai mbahet në dy kopje, një prej të cilave i jepet të shoqëruarit. Pavarësisht kësaj, është detyrë e punonjësit të policisë t'i japë të shoqëruarit një kopje të procesverbalit, që nuk kërkon shumë kohë të plotësohet pasi modeli është i përcaktuar me rubrika të gatshme.

Ne çojmë se, konstatimi i bërë lidhur me mos mbajtjen dhe për rrjedhojë edhe mos dhënien shtetasve të shoqëruar të "Procesverbalit mbi veprimet e kryera me të shoqëruarin" nga ana e punonjësve të policisë që ishin ngarkuar me detyrë dhe kishin kryer veprimet me të shoqëruarit, përbën shkelje të dispozitave të akteve normative në fuqi dhe konkretisht:

1. Nenit 109, pika 5, e ligjit nr. 108/2014 "Për Policinë e Shtetit" ku parashikohet se: *"Punonjësi i policisë, dokumenton në proces-verbal veprimet e kryera me personin e shoqëruar. Procesverbali nënshkruhet në fund të çdo flete nga punonjësi i policisë që ka kryer veprimet dhe personi i shoqëruar. Një kopje e procesverbalit i vihet në dispozicion personit të shoqëruar"*.

2. Kreut VIII, gërma a.3, të Procedurës standarde të punës për "Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit", miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 938 datë 24.07.2019 ku parashikohet:

a.3 - Proces verbali i veprimeve të kryera me personin e shoqëruar:

a.3.1 - Pas kryerjes së veprimeve të verifikimit e sqarimit të rastit për personin e shoqëruar, nga punonjësi i policisë hartohet procesverbali i dokumentimit të veprimeve të kryera me personin e shoqëruar.

a.3.2 – Ky procesverbal pasi plotësohet duke hedhur të gjithë të dhënat sipas përcaktimeve dhe rubrikave të përcaktuara në të, nënshkruhet në fund të çdo faqeje nga punonjësi i policisë që ka kryer veprimet dhe nga vetë personi i shoqëruar.

a.3.3 - Proces verbali i veprimeve të kryera me personin e shoqëruar plotësohet nga punonjësi i policisë që është ngarkuar të kryejë verifikimin dhe trajtimin e çështjes përkatëse për personin e shoqëruar.

a.3.4 - Procesverbali hartohet në dy kopje, një kopje e procesverbalit i jepet detyrimisht personit të shoqëruar dhe kopja tjetër dorëzohet në sekretari/arshivën e njësisë policore.

Mos plotësimi i procesverbalit dhe mos dhënia e një kopjeje personit të shoqëruar përbën shkelje të rëndë dhe ndëshkohet sipas përcaktimeve të bëra në Rregulloren e Policisë.

Sqarojmë se disa të shoqëruar i janë drejtuar institucionit të prokurorisë me kallëzim ndaj veprimeve të punonjësve të policisë. Pas interesimit tonë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë na është dërguar informacioni si vijon:

“Mbi bazën e kallëzimit të shtetasit Maltin Grabovaj është regjistruar procedimi penal nr. 4079, datë 16.06.2020 për veprën penale “Plagosja e rëndë me dashje”, pa autor të njohur.

Pretendimet e shtetasit Menduh Zavalani për dhunë fizike të ushtruar ndaj tij, hetohet në kuadër të procedimit penal nr.3446, datë 18.05.2020 të regjistruar për veprat penale të parashikuara nga nenet 236 etj. të Kodit Penal.

Në bazë të kallëzimeve të shtetasve Silva Caka dhe Alfred Lela janë regjistruar materialet kallëzuese nr. 5973, datë 18.05.2020 dhe nr. 6393, datë 28.05.2020”.

Ankesa që kanë të bëjnë me përdorimin e forcës nga Policia e Shtetit gjatë protestave kanë qenë objekt shqyrtimi edhe në Gjykatën Europiane të të Drejtave të Njeriut. Kjo Gjykatë ka çmuar se ka patur shkelje të nenit 3 (ndalimi i trajtimit çnjerëzor ose degradues) të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut kur ka vënë re se lëndimet e ankuesit nuk justifikoheshin me rrethanat dhe tejkalimi i forcës për personin konkret kishte ndodhur vetëm për faktin se duhej të shpërndahej protesta. Gjithashtu Gjykata ka tërhequr vëmendjen ndaj autoriteteve shtetërore se, nuk kishte patur përpjekje serioze për të përcaktuar rrethanat e përdorimit të forcës dhe shkaku e lëndimeve të ankuesit, punonjësit e përfshirë në ngjarje nuk ishin hetuar dhe as personi që kishte dhënë urdhra nuk kishte qenë subjekt i një hetimi²⁵.

Po ashtu, sjellim në vëmendje se, në datën 17.09.2019, Komiteti European për Parandalimin e Torturës, Trajtimit ose Dënimit Çnjerëzor ose Poshtëruës (më poshtë CPT) ka bërë publik raportin mbi vizitat që ka kryer në disa institucione të privimit të lirisë në Shqipëri, nga data 20 deri në datën 30 Nëntor 2018²⁶. Në pjesën e raportit që ka të bëjë për Policinë e Shtetit, shkronja “A”, përshkruhen konstatimet dhe rekomandimet për trajtimin e personave të ndaluar/arrestuar. Disa nga rekomandimet që kanë të bëjnë me parandalimin e keqtrajtimit, përdorimin e forcës dhe hetimin e ankesave ndaj Policisë së Shtetit, janë si më poshtë:

“A. Ndalimi nga Policia

2. Keqtrajtimi

14. Është thelbësore të sigurohet që punonjësit e policisë në të gjitha nivelet të jenë të vetëdijshëm se qeveria është e vendosur të pengojë keqtrajtimin e personave të privuar nga liria duke forcuar përgjegjshmërinë e policisë dhe duke hetuar në mënyrë efektive pretendimet për keqtrajtim.

²⁵ Shih vendimet *Gazioglu and Others v. Turkey*, 17 maj 2011, kërkesa nr. 29835/05 dhe *Suleyman Çelebi and Others v. Turkey*, 24 maj 2016, kërkesa nr. 37273/10.

²⁶ Për më tepër shih:

<https://www.coe.int/en/web/cpt/-/council-of-europe-anti-torture-committee-publishes-report-on-alban-3>

CPT rekomandon që autoritetet shqiptare të dyfishojnë përpjekjet e tyre për të luftuar keqtrajtimin nga punonjës të policisë. Në veçanti, duhet t'u silltet në vëmendje punonjësve të policisë se të gjitha format e keqtrajtimit (përfshirë dhunën verbale) janë të paligjshme dhe do të dënohet në përputhje me rrethanat.

Oficerët e policisë gjithashtu duhet të trajnohen që të mos përdorin forcë më shumë sesa është nevojshme kur kapin një person dhe pasi ai është arrestuar dhe mbahet nën kontroll, nuk mund të ketë asnjë justifikim për goditjen e tij. Kur vlerësohet e nevojshme të prangoset një person, prangat në asnjë rrethanë nuk duhet të jenë tepër të shtrënguara dhe duhet të mbahen për aq kohë sa është e nevojshme.

15. Përbërës thelbësor i çdo strategjie për të parandaluar keqtrajtimin është shqyrtimi i kujdesshëm nga autoritetet kompetente i të gjitha ankesave për keqtrajtim dhe dhënia e një dënimi të përshtatshëm. Nëse nuk ka reagim të shpejtë dhe efektiv ndaj një të dhëne për keqtrajtim, personat e cënuar shpejt do të besojnë se këto shkelje nuk ndëshkohen. Në mënyrë që hetimi mbi keqtrajtimin e mundshëm të policisë të jetë efektiv, procedura duhet të jetë e pavarur dhe e paanshme. Hetime të tilla duhet të përputhen ndër të tjera me kriterin e shpejtësisë, tërësisë dhe gjithëpërfshirjes.

16. Nga konsultimet që delegacioni zhvilloi me prokurorin e rrethit përgjegjës për rastet e keqtrajtimin të referuar nga IEVP 313, është vënë në dijeni se korrespondenca e dërguar nga burgu, thjesht ishte bashkuar me dosjen përkatëse të hetimit penal lidhur me kallëzimet ndaj personave në fjalë, pa u kryer ndonjë veprim hetimor në lidhje me pretendimet e keqtrajtimin (siç është marrja e një deklaratë ose kërkimi i një ekzaminimi mjeko-ligjor). Kur u pyet për një shpjegim në lidhje me këtë gjendje, prokurori u shpreh se, sipas mendimit të tij, nuk kishte pasur prova të pamjaftueshme për të hapur një hetim penal për pretendimet e keqtrajtimin të policisë.

Sipas mendimit të CPT, mungesa totale e veprimit hetimor nga prokurori në dritën pretendimeve konkrete për keqtrajtim të policisë, të cilat u mbështetën edhe me prova mjekësore (nga burgu), është e pajustificuar.

CPT rekomandon që autoritetet shqiptare të ndërmarrin hapat e nevojshëm për të ofruar trajnime për prokurorët përkatës në mënyrë që të sigurohet:

- ankesat dhe informacionet e tjera për keqtrajtimin të policisë të hetohen në mënyrë efektive;

- sa herë që prokurorët të marrin ankesa ose informacione të tjera treguese për keqtrajtim të policisë, të urdhërohet menjëherë një ekzaminimi mjeko-ligjor.

17. Në përgjithësi, CPT ka vërejtje për faktin se shqyrtimi i pretendimeve për keqtrajtim të policisë i kishte kaluar të njëjtit prokuror që ishte përgjegjës për hetimin penale kundër personit, i cili pretendohet se është keqtrajtuar. Sipas prokurorit, i cili u takua nga delegacioni, kjo ishte praktikë normale në sistemin gjyqësor shqiptar. Sipas mendimit të CPT-së, një përgjegjësi e tillë e dyfishtë mund të çënojë paanshmërinë të prokurorit në fjalë. Prandaj, Komiteti rekomandon që rastet e keqtrajtimin të mundshëm të policisë të hetohen nga prokurorë të cilët nuk kanë lidhje me hetimet penale kundër viktimave të pretenduara të keqtrajtuara”.

Për sa më lart, bazuar në nenin 63, pika 3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku thuhet se: "Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut" si dhe në mbështetje të nenit 21/b të Ligjit

Nr.8454 datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit" i ndryshuar ku përcaktohet se: "Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që, sipas tij, ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive".

REKOMANDOJMË:

1. Marrjen e masave të nevojshme nga strukturat përkatëse të Policisë së Shtetit, për analizimin e thelluar, me objektivitet dhe profesionalizëm, të veprimeve/mosveprimeve të kundërligjshme, të trajtuar hollësisht në pjesën arsyetuese të këtij rekomandimi, të kryera nga punonjës të Policisë së Shtetit, si ndaj disa shtetasve që në datën 17.05.2020 kanë qenë në godinën e Teatrit Kombëtar për të kundërshtuar prishjen e tij, ashtu edhe të protestuesve në ditën në vijim.

2. Identifikimin dhe fillimin e ecurisë disiplinore, për ata drejtues apo punonjës të Policisë së Shtetit, që me veprimet/mosveprimet e tyre, nuk kanë garantuar jetën dhe shëndetin e popullatës (përfshi edhe punonjësit shtetërorë), duke mbështetur veprimtari/operacione, të cilat kanë përbërë në vetvete, apo kanë çuar në grumbullime masive, në kohën kur ishte shpallur gjendja e fatkeqësisë natyrore.

3. Identifikimin dhe fillimin e ecurisë disiplinore, për ata punonjës të Policisë së Shtetit që kanë kryer veprime me të shoqëruarit në organet e policisë, për arsye se nuk kanë zbatuar detyrimin ligjor për mbajtjen e procesverbalit mbi veprimet e kryera me të shoqëruarit dhe dhënien e një kopjeje të tij, personave të shoqëruar, si dhe nuk kanë dokumentuar hyrjen e personave të shoqëruar në ambientet e Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë.

3. Identifikimin dhe fillimin e ecurisë disiplinore, për ata punonjës të Policisë së Shtetit që me veprimet e tyre kanë cenuar informimin e qytetarëve, duke penguar punonjësit e organeve të medias për të dokumentuar pjesë të ndryshme nga këto ngjarje.

4. Identifikimin dhe fillimin e ecurisë disiplinore, për ata drejtues të Policisë së Shtetit, që nuk lejuan vënien në dispozicion të pamjeve filmike të kërkuara nga institucioni i Avokatit të Popullit, duke penguar kështu hetimin administrativ të nisur nga institucioni ynë.

5. Marrjen e masave të nevojshme organizative dhe financiare nga strukturat qendrore të Policisë së Shtetit, për pajisjen e të gjithë punonjësve të policisë së shtetit, me mjetet mbrojtëse për parandalimin e përhapjes së infeksionit të shkaktuar nga virusi COVID-19, në zbatim të akteve normative të miratuara me qëllim për të garantuar veprimtarinë ligjore të Policisë së Shtetit, gjatë periudhës së pandemisë dhe që ata të mos bëhen burim rreziku për përhapjen e tij. Të njëjtat masa të merren dhe respektohen edhe për shtetasit e shoqëruar/ndaluar/arrestuar në ambientet e policisë së shtetit, apo edhe gjatë transportit të tyre për në ambientet e mësipërme.

6. Identifikimin dhe fillimin e ecurisë disiplinore, ndaj atyre drejtuesve të strukturave të Policisë së Shtetit, që nuk kanë marrë masat e nevojshme për pajisjen e disa punonjësve të policisë, të caktuar me shërbim tek ish godina e Teatrit Kombëtar dhe e atyre që ishin me shërbim në komisariate, si dhe të personave të shoqëruar, me maska mbrojtëse, doreza

e dezinfektantë, në zbatim të akteve normative të nxjerra nga organet kompetente, me qëllim parandalimin e përhapjes së infeksionit të shkaktuar nga virusi COVID-19.

7. Marrjen e masave të nevojshme organizative dhe financiare nga strukturat qendrore të Policisë së Shtetit, për të bërë të mundur pajisjen sa më parë të të gjithë punonjësve të Policisë së Shtetit, me numrat personal të identifikimit të tyre, duke respektuar kështu detyrimet ligjore për uniformën e punonjësve të Policisë së Shtetit, por edhe për të identifikuar më më lehtësi shkeljet ligjore që mund të kryhen prej tyre gjatë kryerjes së detyrave. Identifikimin dhe fillimin e ecurisë disiplinore, për ata drejtues të Policisë së Shtetit, që kanë lejuar ushtrimin e detyrës nga punonjës të Policisë së Shtetit, pa numrin përkatës të identifikimit.

8. Marrjen e masave të nevojshme organizative, nga strukturat qendrore dhe vendore të Policisë së Shtetit, për të bërë të mundur trajnimin e vazhdueshëm të punonjësve të policisë, për njohjen dhe respektimin e të drejtave kushtetuese e ligjore të shtetasve, për mënyrën dhe masën e përdorimit të forcës, si dhe për sjelljen me etikë dhe korrektesë me shtetasit.

9. Shpejtimin e hetimit të procedimit penal të regjistruar nga organi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë ndaj strukturave të Policisë së Shtetit për veprën penale të "Shpërdorimit të detyrës", parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, lidhur me dërgimin e forcave RENEA tek ish godina e Teatrit Kombëtar, para shembjes së saj.

10. Shpejtimin e hetimit të procedimeve penale të regjistruara nga organi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë për kallëzimet e bëra nga shtetasit Maltin Grabova, Menduh Zavalani, Alfred Lela dhe Silva Caka, duke mbajtur në konsideratë rekomandimet e bëra nga Komiteti European për Parandalimin e Torturës, Trajtimin ose Dënimit Çnjerëzor ose Poshtëruës, të cilat i kemi pasqyruar më sipër.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do merrni në zbatim të këtij rekomandimi, na vini në dijeni brenda afatit ligjor 30 ditor, të parashikuar në nenin 22 të Ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

AVOKATI I POPULLIT
Erinda BALLANCA

